



Bruksel, 10.11.2015  
COM(2015) 611 final

**KOMUNIKATA NGA KOMISIONI PËR PARLAMENTIN EVROPIAN,  
KËSHILLIN EVROPIAN, KOMISIONIN EVROPIAN EKONOMIK DHE  
SOCIAL DHE KOMISIONIN E RAJONEVE**

**Strategjia e BE-së për zgjerim**

{SWD(2015) 210final}  
{SWD(2015) 211final}  
{SWD(2015) 212final}  
{SWD(2015) 213final}  
{SWD(2015) 214final}  
{SWD(2015) 215final}  
{SWD(2015) 216final}

**SHQ**

**SHQ**

## I. AGJENDA PËR ZGJERIM – TË ARRITURAT DHE SFIDAT

Kjo Komunikatë paraqet një strategji afatmesme të politikës së BE-së për zgjerim që mbulon periudhën e mandatit të Komisionit. Ajo paraqet një drejtim të qartë, si edhe kornizën dhe mjetet për mbështetjen e vendeve përkatëse për të adresuar çështjet dhe kërkesat kryesore lidhur me procesin e pranimit. Kjo Komunikatë ofron një mundësi të qartë për vendet që aspirojnë të bëhen anëtare, si për të shënuar progres të konsiderueshëm në rrugët e tyre drejt BE-së në të ardhmen, ashtu edhe për të mbledhur përfitimet e anëtarësimit më të shpejtë edhe para anëtarësimit.

Politika e BE-së për zgjerim është një investim në paqen, sigurinë dhe stabilitetin në Evropë. Ajo ofron mundësi më të mëdha ekonomike dhe tregtare që shërbejnë për të mirën, si të BE-së ashtu edhe të vendeve që aspirojnë të bëhen pjesë e shteteve anëtare të BE-së. Perspektiva e anëtarësimit në BE ka ndikim të fuqishëm në transformimin e vendet në fjalë, duke imponuar ndryshime pozitive demokratike, politike, ekonomike dhe shoqërore.

Zgjerimet më të fundit në Evropën Qendrore dhe Lindore kanë krijuar shumë mundësi për qytetarët, kompanitë, investitorët, konsumatorët dhe studentët e shteteve anëtare më të reja të BE-së. Këmbimet tregtare dhe investimet janë rritur. Tregu unik i BE-së është tregu më i madh në botë, i cili u shërben 500 milionë qytetarëve dhe i cili gjeneron 23% të BPV të botës.

Zgjerimi është një proces i rreptë por i drejtë, i cili bazohet mbi kritere të njohura dhe leksione të mësuara nga e kaluara. Të sigurohet që shtetet e ardhshme anëtare janë të përgatitura mirë është një gjë shumë e rëndësishme për kredibilitetin e politikës së zgjerimit dhe për mbështetjen publike, si të shteteve anëtare aktuale ashtu edhe të shteteve anëtare të ardhshme.

Secili vend vlerësohet në bazë të meritës së vet, ashtu që të sigurojë stimulimet deri në ndjekjen e reformave me ndikim të gjerë.

Agjenda aktuale e zgjerimit mbulon vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqinë<sup>1</sup>. Negociatat për pranimin e Turqisë janë hapur që në vitin 2005, mirëpo ato po lëvizin ngadalë përpara. Negociatat për pranim me Malin e Zi janë duke u zhvilluar që nga viti 2012, kurse me Serbinë që nga viti 2014. Procesi i anëtarësimit në BE-së të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë – vend kandidat që nga viti 2005 – gjendet në një situatë pa rrugëdalje. Shqipërisë i është dhënë statusi i kandidatit në vitin 2014 dhe ajo po adreson një numër të prioriteteve kryesore para se Komisioni të mund të rekomandojë hapjen e negociatave për pranim. Marrëveshja për Stabilitet Asocim (MSA) me Bosnjën e Hercegovinën ka hyrë në fuqi në muajin qershor. MSA me Kosovën\* është nënshkruar në muajin tetor.

Derisa ka pasur përparim të rëndësishëm në shumicën e vendeve, në shumë fusha, gjatë vitit të kaluar, këto vende janë ballafaquar me sfida të tilla që asnjëri prej tyre nuk do të jetë i përgatitur që t'i bashkohet BE-së gjatë mandatit aktual të Komisionit, i cili do të skadojë në fund të vitit 2019. Të gjitha këto vende ballafaqohen me sfida të mëdha sa i përket sundimit të ligjit. Sistemet gjyqësore nuk janë pavarura, efikase dhe mjaftueshëm llogaridhënëse. Nevojiten ende përpjekje të mëdha për adresimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Derisa të drejtat themelore shpesh mbrohen kryesisht me ligj, shkeljet në praktikë vazhdojnë. Sigurimi i lirisë së shprehjes është një sfidë e veçantë, me zhvillime negative në një numër vendesh.

<sup>1</sup> Pas një vendimi të qeverisë së Islandës, kjo e fundit nuk është e angazhuar më në negociata për anëtarësim. Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e OKB-së 1244/1999 dhe opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

Në administratës publike duhet të bëhen reforma të thella, për të siguruar kapacitetet e nevojshme administrative dhe për të parandaluar shkallën e lartë të politizimit dhe mungesën e transparencës. Funksionimi i institucioneve demokratike, po ashtu, kërkon vëmendje. Në kuptim të transformimit demokratik, parlamentet kombëtare duhet të jenë në qendër të procesit të reformimit në secilin prej vendeve në zgjerim, në mënyrë që të garantojnë llogaridhënie demokratike dhe gjithëpërfshirje, të cilat janë parakusht për një proces të suksesshëm të reformimit. Duhet të punohet më shumë me përfaqësues të shoqërisë civile, për të shtrirë reformat në shoqëri.

Ballkani Perëndimor dhe Turqia kanë qenë shumë të prekura nga kriza e refugjatëve. Konfliktet e tilla, si lufta civile në Siri dhe në Irak, kanë rezultuar në një rritje të madhe të lëvizjes së refugjatëve, përmes Turqisë dhe Ballkanit Perëndimor. Turqia po u ofron mbështetje të madhe më shumë se 2 milionë refugjatëve sirianë në territorin e saj. Ballkani Perëndimor, në veçanti ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia, kanë menaxhuar një fluks prej mbi dyqind mijë qytetarëve të vendeve të treta që kanë kaluar përmes vendeve të tyre që nga fillimi i këtij viti.

Për të adresuar këtë fenomen, kërkohet një rritje e bashkëpunimit me gjithë rajonin, në mënyrë që të identifikohet personat që kanë nevojë për mbrojtje, t'u ofrohet ndihmë, të sigurohen kufijtë e jashtëm të BE-së dhe të shkatërrohen rrjetet kriminale që kontrabandojnë njerëz. BE-ja është duke ofruar mbështetje të madhe në këtë drejtim. Për më tepër, Komisioni Evropian ka propozuar që lista e vendeve të sigurta të origjinës në BE të përfshijë të gjitha vendet në zgjerim. Në muajin tetor, Këshilli i Evropës e ka përshëndetur planin e përbashkët të veprimit BE-Turqi për menaxhimin e refugjatëve dhe migrimin, si pjesë e një agjende gjithëpërfshirëse të bashkëpunimit, bazuar në ndarjen e përgjegjësisë, angazhimeve të dyanshme dhe sistemimit. Reagimi ndaj krizës aktuale të refugjatëve është diskutuar në konferencën e nivelit të lartë “Rrugë kalimi i Mesdheut Lindor dhe Ballkanit Perëndimor”, më 8 tetor, në Luksemburg, si edhe në takimin e 25 tetorit për rrugën e migrimit të Ballkanit Perëndimor, ku është arritur pajtimi i liderët e Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Gjermanisë, Greqisë, Hungarisë, Rumanisë, Serbisë dhe Sllovenisë për një plan veprimit 17 pikësh.

Shumica e vendeve, po ashtu, ballafaqohen me sfida të mëdha në kuptim të zhvillimit ekonomik dhe konkurrencës, me shkallë të ulëta të investimeve dhe me shkallë të larta të papunësisë. Shkallët e të hyrave mbesin të ulëta krahasuar me ato në BE dhe konvergjenca drejt BE-së është po ashtu e ulët. Me përjashtim të Turqisë, shumica e këtyre ekonomive janë të vogla, me eksport të kufizuar. Reformat ekonomike janë qenësore për krijimin e vendeve të punës, rritjen ekonomike dhe rritjen e interesimit të investitorëve. Në këtë Komunikatë, i është vënë një theks i veçantë bashkëpunimit rajonal dhe rritjes së zhvillimit ekonomik në rajon dhe bashkëpunimit rajonal. Progres i rëndësishëm është shënuar këtu, veçanërisht përmes “procesit të Berlinit” dhe formatit “Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor”, i cili bën bashkë shefat e shteteve dhe të qeverive të vendeve të rajonit, i cili fuqizon pronësinë e vendeve në bashkëpunim rajonal.

Natyra e sfidave më afatgjata me të cilat janë ballafaquar vendet në zgjerim nxjerr në pah nevojën për të ritheksuar fokusimin kryesor në parimin “gjërat themelore në rend të parë” të procesit të anëtarësimit. Përparim po bëhet, në mënyrë të veçantë në hartimin e legjislacionit dhe në krijimin e strukturave të nevojshme administrative. Megjithatë, në të gjitha këto vende, zbatimi efektiv i këtij legjislacioni shumë shpesh mungon. Komisioni do të vazhdojë të orientojë përpjekjet e tij që të sigurohet se vendet i prioritetizojnë reformat në fushat kryesore të sundimit të ligjit, përfshirë reformat në gjyqësor, adresimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, si edhe të drejtat themelore, përfshirë lirinë e shprehjes dhe luftimin e diskriminimit,

sidomos ndaj komunitet LGBTI dhe komunitet rom, si edhe funksionimin e institucioneve demokratike, përfshirë reformën e administratës publike. Ai do të përqendrohet gjithashtu në promovimin e zhvillimit ekonomik dhe në fuqizimin e konkurrencës. Ky fokusim në gjërat themelore që ndërlidhen me vlerat e BE-së do të jenë thelbi i politikës së zgjerimit, gjatë këtij mandati të Komisionit.

Zgjerimi duhet të kuptohet si proces që mbështet reformën dhe ndryshimet fundamentale që nevojiten për të përmbushur obligimet e anëtarësimit në BE. Ndryshimet e tilla pashmangshëm kërkojnë kohë. Kjo e bën edhe më të rëndësishme nevojën të riafirmohet pa ekuivoke perspektiva evropiane e vendeve në zgjerim. Nëse perspektiva e rrugëtimit drejt BE-së shihet si reale dhe e besueshme, rreziku i vendeve që largohen nga BE-ja do të zvogëlohet, ashtu siç do të zvogëlohet edhe rreziku i disiluzionit me këtë proces ose dështimit apo heqjes dorë nga reformat. Zgjerimi mund të jetë i dobishëm për BE-në dhe për vendeve partnere vetëm nëse ka reformë të vërtetë dhe të qëndrueshme. Përmes këtij procesi vendet do të jenë plotësisht të gatshme t'i bashkohen BE-së dhe do të jenë në gjendje t'i vjelin frytet dhe t'i pranojnë obligimet që dalin nga anëtarësimi.

Këtë vit, ky Komision ka prezantuar një qasje të fuqizuar ndaj vlerësimeve të tij në raportet vjetore të progresit. Përveç raportit të progresit, më shumë vëmendje i është kushtuar situatës aktuale të vendeve dhe vlerësimit se ku qëndrojnë ato në kuptim të përgatitjes për të marrë obligimet për anëtarësim. Në të njëjtën kohë, këto raporte japin edhe rekomandime më të qarta se çfarë pritet prej këtyre vendeve, si në periudhën afatshkurtër ashtu edhe në periudhën afatgjatë. Shkallët e harmonizimit të vlerësimit janë përdorur për të vlerësuar situatën aktuale dhe nivelin e progresit, duke e rritur kështu krahasueshmërinë në mes vendeve. Qasja e re e raportimit siguron transparencë më të madhe në procesin e pranimit, gjë që duhet të lehtësojë shqyrtimin më të kujdesshëm të reformave nga të gjitha palët e interesit. Kjo qasje e re është aplikuar në veçanti në një numër të fushave pilot, të cilat janë të lidhura drejtpërdrejt me reformën rrënjësore që duhet bërë në rrugëtimin drejt BE-së. Detaje më të hollësishme janë paraqitur në Shtojcën 2.

Në vendet në zgjerim nevojitet një rol më i madh i organizatave të shoqërisë civile, si edhe një mjedis më i favorshëm dhe me më shumë mundësi për të inkurajuar zhvillimin e tyre. Kjo është e nevojshme për të rritur llogaridhënien politike dhe për të kuptuar më në thelb reformat e ndërlidhura me pranimin. Vetëdijësimi i publikut për përfitimet që tashmë ka sjellë dhe që mund të sjellë BE-ja në rajon është qenësor për inkurajimin e liderëve politikë që të ndjekin reformat fuqishëm. Komunikimi efektiv për mënyrën se si ndikon procesi i zgjerimit në jetën e qytetarëve është thelbësor për sigurimin e mbështetjes publike. Kjo kërkon përpjekje të përbashkëta të BE-së dhe shteteve anëtare të saj, si edhe të qeverive dhe të shoqërisë civile në vendet në zgjerim.

Perspektiva e qartë e anëtarësimit në BE është faktor kryesor i stabilitetit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Ajo mbështet progresin drejt përmbushjes së kritereve të caktuara, përfshirë ato të Procesit të Stabilizim Asociimit. Marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe bashkëpunimi rajonal gjithëpërfshirës janë themelore. Angazhimi, si në nivel bilateral ashtu edhe në nivel rajonal, po ashtu është në një nivelin më të lartë deri më tash. Në të njëjtën kohë, kërkojnë përpjekje të vazhdueshme për të adresuar çështjet bilaterale ndërmjet vendeve në zgjerim dhe me shtetet anëtare të BE-së, me mbështetjen e OKB-së aty ku kjo është e nevojshme. Kjo duhet të kontribuojë në tejkalimin e trashëgimisë së kaluar, në mënyrë të veçantë në Ballkanin Perëndimor, ku, përkundër progresit të arritur, nevojitet ende kohë që të shërohen plotësisht plagët e konflikteve të fundit. Në mbështetje të stabilitetit dhe prosperitetit në Ballkanin Perëndimor, ky është një investim jo vetëm për të ardhmen e rajonit, por edhe në interes të vetë BE-së.

Sa i përket Turqisë, hapat pozitivë inkurajues në bisedimet për zgjidhjen e çështjes së Qipros paraqesin një mundësi të rëndësishme për rritje të angazhimit më të gjerë, përfshirë këtu edhe negociatat për anëtarësim.

Për të mbështetur përpjekjet për reforma në të gjitha vendet në zhvillim, Komisioni synon të shfrytëzojë maksimalisht mekanizmat dhe forumet ekzistuese, qoftë përmes strukturave të Marrëveshjes së Asocim-Stabilizimit, negociatave për pranim ose iniciativave të drejtuara nga Komisioni, sipas specifikave të vendeve, si dialogët e nivelit të lartë. Komisioni do të vazhdojë të sigurojë gjithashtu mbështetje të duhur financiare, në kuadër të Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA II). Përmes IPA II, BE-ja ofron 11.7 miliardë € për periudhën 2014-2020, për të mbështetur vendet në zgjerim për përgatitjen e tyre për anëtarësim dhe për bashkëpunim ndërkufitar e bashkëpunim rajonal. Nga mbështetja e IPA-s do të financohen gjithashtu masat që promovojnë zhvillimin dhe rritjen ekonomike dhe do të ndihmohen vendet që të merren me ndikimin e krizës aktuale të refugjatëve. Një përmbledhje e financimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë për periudhën 2007-2014, për të mbështetur strategjinë për zgjerim, përfshirë këtu edhe rezultatet dhe efektet, është vënë në dispozicion në uebfaqen e Komisionit Evropian.

## II. RIAFRMIMI I FOKUSIT TE ÇËSHTJET FUNDAMENTALE

Politika e zgjerimit mbetet e fokusuar në parimin “çështjet fundamentale në rend të parë”. Çështjet thelbësore të sundimit të ligjit, të drejtat themelore, forcimi i institucioneve demokratike, duke përfshirë reformën e administratës publike, si edhe zhvillimin ekonomik dhe konkurrencën, mbeten prioritetet kyçe të procesit të zgjerimit. Këto çështje reflektojnë rëndësinë që BE-ja ia kushton vlerave thelbësore dhe prioritetëve të politikave të përgjithshme.

Çështjet fundamentale ekonomike dhe institucionale janë të pandashme dhe reciprokisht përforcuese. Sundimi i ligjit dhe zhvillimi ekonomik mund të shihen si dy anë të së njëjtës medalje. Forcimi i sundimit të ligjit e rrit sigurinë ligjore, inkurajon dhe mbron investimet dhe kontribuon në mënyrë të konsiderueshme në mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe të konkurrencës. Anasjelltas, reformat ekonomike dhe integrimi e krijojnë mundësi për stabilitet afatgjatë të vendeve. Është e domosdoshme që procesi i zgjerimit të lehtësojë këtë sinergji, të ofrojë nxitje më të fuqishme për reforma ekonomike, në mënyrë që shtetet që aspirojnë anëtarësimin t'i gëzojnë përfitimet nga ekonomitë e tregut funksional dhe sundimi i fuqishëm të ligjit, para se ato të anëtarësohen, në këtë mënyrë që të kontribuojnë për funksionimin e mirë të Bashkimit Evropian si tërësi.

Adresimi si duhet i çështjeve fundamentale është kyç për plotësimin e kriterëve për anëtarësim të Kopenhagës dhe të Madridit<sup>2</sup>. Kjo ndihmon gjithashtu të sigurohet që si shtetet e ardhshme anëtare ashtu edhe shtetet anëtare aktuale të mund t'i vjelin plotësisht frytet e zgjerimit të ardhshëm të BE-së.

Fokusimi te çështjet fundamentale reflektohet në fusha specifike, të cilat janë subjekt i raportimit të përforcuar në raportet e shteteve. Më tutje, hollësitë për këto fusha (gjyqësori, lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, liria e shprehjes, kriteret ekonomike, reforma e administratës publike, prokurimi publik, statistikat dhe kontrolli financiar) janë përfshirë në shtojcë.

---

<sup>2</sup> Kjo në veçanti ka të bëjë me ndërtimin e nevojshëm të kapacitetit administrativ që *acquis* të zbatohet me efikasitet.

## **a) Sundimi i ligjit**

Sundimi i ligjit është vlerë themelore mbi të cilin BE-ja është themeluar dhe përbën thelbin e procesit të anëtarësimit. Vendet që aspirojnë të hyjnë në Bashkim Evropian kanë nevojë të krijojnë dhe të promovojnë që në fazë të hershme funksionim të duhur të institucioneve kryesore që janë të nevojshme për sigurimin e sundimit të ligjit. Sundimi i ligjit nuk është vetëm një parim thelbësor demokratik, po është instrument qenësor për një mjedis të qëndrueshëm për biznes, duke ofruar siguri ligjore për operatorët ekonomikë, mbështetje për konsumatorët dhe nxitje të investimeve, vende të punës dhe zhvillimit.

Forcimi i sundimit të ligjit mbetet sfida kyçe për shumicën e vendeve të procesit të zgjerimit, në veçanti nga aspekti i përmirësimit të funksionimit dhe pavarësisë së gjyqësorit, i cili vazhdon të minohet përmes rasteve të drejtësisë selektive dhe ndërhyrjeve politike në punën e organeve gjyqësore. Në luftën kundër krimit të organizuar, sukcesi i ndjekjes penale të individëve nuk është harmonizuar përsa i përket shpërbërjes së rrjeteve kriminale dhe konfiskimit të aseteve. Korrupsioni mbetet i përhapur gjithandej, në të gjitha vendet, për shkak të mosndëshkimit të vazhdueshëm, posaçërisht korrupsioni i nivelit të lartë. Përparimi i mëtutjeshëm në këto fusha kërkon vullnet të fortë politik që shpie drejt rezultateve të prekshme.

Vitin e kaluar, ka pasur disa zhvillime pozitive sa i përket sundimit të ligjit. Kjo, kryesisht, ka të bëjë me krijimin e kornizave ligjore dhe strukturave institucionale. Në Mal të Zi, për shembull, është arritur përparim i mirë në këtë drejtim të hapjes së negociatave. Tani duhet të sigurohet zbatimi i tërësishëm.

Dymbëdhjetë muajt e fundit, janë parë gjithashtu një numër kërcënimesh serioze për sundimin e ligjit. Në Turqi, pavarësia e sistemit gjyqësor është minuar, jo vetëm nga ndërhyrja politike në raste individuale dhe nga ricaktimi i zyrtarëve të gjyqësorit dhe atyre për zbatimin e ligjit, por edhe përmes arrestimit të gjykatësve apo ndërrimit të pozitës së tyre, për të pamundësuar vendimmarrjen. Rasti i përgjimeve në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë ka nxjerrë gjithashtu në dritë sulme të shumta në sundimin e ligjit, abuzime të të drejtave themelore dhe dobësi në funksionimin demokratik të shtetit. Këto çështje duhet të adresohen me urgjencë. Këto mangësi janë shfaqur pavarësisht prej shumë reformave që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit dhe të tjera, si në aspektin e legjislacionit ashtu edhe në themelimin e strukturave përkatëse institucionale. Këto raste e nxjerrin në pah nevojën që në vendet në proces të zgjerimit të bëjnë reforma në praktikë dhe jo vetëm në letër.

Kjo gjithashtu vë në pah rëndësinë e vazhdueshme të vëmendjes së fuqishme që gjatë procesit të anëtarësimit duhet t'u kushtohet çështjeve që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit dhe, në veçanti, me zbatimin e qasjes së re në negociatat për anëtarësim të Kapitullit 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe Kapitullit 24 - Drejtësia, liria dhe siguria. Kjo qasje, e aplikuar nga Komisioni në vitin 2012, u jep prioritet reformave në fushën e sundimit të ligjit, duke siguruar që ato të adresohen sa më herët që të jetë e mundshme, gjatë procesit të anëtarësimit. Kjo u jep kohë maksimale vendeve që para anëtarësimit të krijojnë një regjistër shënimesh të rezultateve konkrete, të cilat sigurojnë qëndrueshmëri të reformave. Për shembull, vendet duhet të krijojnë regjistra shënimesh të besueshme të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare, në rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit, përfshirë nivelin e lartë, me dënime adekuate dhe konfiskim të aseteve.

Sikurse një numër i shteteve anëtare të BE-së, edhe rajoni është prekur nga fenomeni i luftëtarëve të huaj terroristë dhe nga radikalizmi në rritje. Disa qindra persona janë larguar nga rajoni për të luftuar në zonat e konfliktit, siç janë Siria dhe Iraku. Nevojitet një strategji gjithëpërfshirëse me përkrahje politike të nevojshme që të parandalohet dhe luftohet radikalizmi, në bashkëpunim

të ngushtë me udhëheqësit e komuniteteve fetare, me punëtorët social dhe punëtorët e sistemit të arsimit dhe me organizata të rinjve. Rastet e gjuhës së urrejtjes duhet të adresohen më fuqishëm. Kërkohej një qasje e dedikuar nga inteligjenca dhe komuniteti i zbatimit të ligjit për të ndërprerë veprimtarinë terroriste dhe për të parandaluar udhëtimin e terroristëve dhe qarkullimin e paligjshëm të armëve. Gjithashtu, nevojitet edhe një politikë koherente gjyqësore ndaj shkelësve të ligjit.

### **b) Të drejtat themelore**

Të drejtat themelore përbëjnë thelbin e vlerave të BE-së dhe elementin thelbësor të procesit të anëtarësimit. Të drejtat themelore, në masë të madhe, janë të përfshira në legjislacionin e vendeve në zgjerim, mirëpo duhet të bëhet më shumë për të siguruar se ato respektohen plotësisht në praktikë.

Liria e shprehjes dhe medieve mbetet një shqetësim i veçantë. Në vitin 2014 janë vërejtur raste të kthimit prapa në këtë fushë. Ky trend ka vazhduar në vitin 2015. Ka pasur ndërhyrje të pa-justifikueshme në punën e transmetuesve publikë në Ballkanin Perëndimor si edhe kërcënime të gazetarëve dhe përparim të kufizuar sa i përket vetë-rregullimit të medieve. Liria e shprehjes është kufizuar edhe më shumë në Turqi, si përmes ndryshimeve legjislative ashtu edhe në praktikë, përmes ndjekjeve penale për fyerje të supozuara të politikanëve të nivelit të lartë, përfshirë Presidentin, dhe përmes gjobave të larta që kishin efekt kufizues për raportim të medias së lirë. Komisioni vazhdon t'i japë prioritet punës për lirinë e shprehjes dhe të medieve në procesin e anëtarësimit në BE. Më 4 nëntor të vitit 2015, Komisioni mbajti edicionin e tretë të Konferencës Speak-Up!, duke tubuar palët kyçe të interesit nga mediet, shoqëria civile dhe autoritetet kombëtare për të adresuar sfidat kyçe dhe për të forcuar përpjekjet për mbështetje të lirisë së shprehjes në rajon.

Ekziston nevoja për mbrojtje më të mirë të minoriteteve, në veçanti të romëve. Romët në Ballkanin Perëndimor dhe në Turqi vazhdojnë të jenë viktima të racizmit, diskriminimit dhe përjashtimit social dhe shumica e romëve jetojnë në varfëri të skajshme, me mungesë të qasjes së mjaftueshme në shërbime shëndetësore, në arsim dhe trajnim, në strehim dhe në punësim.

Diskriminimi dhe armiqësia ndaj grupeve tjera të cënueshme, përfshirë ato në bazë të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, gjithashtu janë një shqetësim serioz. Nevojitet një qasje për zero-tolerancë ndaj dhunës, frikësimit dhe gjuhës së urrejtjes kundër këtyre apo ndaj personave tjerë të cënueshëm. Kërkohej punë e mëtejme për të promovuar barazinë në mes të grave dhe burrave, përfshirë edhe trajtimin e dhunës në familje, për të përmirësuar të drejtat e fëmijëve dhe për të përkrahur personat me aftësi të kufizuara, si edhe për të lehtësuar qasjen në drejtësi. Nevojitet një kornizë më e fuqishme institucionale për mbrojtjen e të drejtave themelore, posaçërisht për të promovuar punën e Avokatit të Popullit dhe për të përkrahur punën e organizatave joqeveritare (OJQ) dhe mbrojtësit e të drejtave të njeriut.

### **c) Zhvillimi ekonomik dhe konkurrenca**

Anëtarësimi në BE-së nuk ka të bëjë vetëm me harmonizimin me rregullat dhe standardet e BE-së. Ao ka të bëjë edhe me përgatitjen e vendit ekonomikisht për anëtarësim për t'u siguruar se ai mund t'i vjelë të gjitha benifitet nga anëtarësimi në BE dhe, në të njëjtën kohë, të kontribuojë në zhvillimin dhe përparimin e ekonomisë së BE-së.

Sfida të konsiderueshme mbesin në të gjitha vendet në zgjerim përse i përket reformës ekonomike, konkurrencës, krijimit të vendeve të punës, konsolidimit fiskal dhe zhvillimit gjithëpërfshirës. Ndonëse të gjitha vendet në zgjerim në masë të madhe e kanë ruajtur stabilitetin e

përgjithshëm makroekonomik dhe është duke vazhduar rimëkëmbja modeste, të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor përballen me sfida të mëdha strukturore ekonomike, me sfida sociale, me norma të larta të papunësisë dhe me nivel të ulët të të ardhurave. Infrastruktura dhe sistemet e arsimit kanë nevojë për përmirësim. Mungesa e mundësive për vende pune tërheqëse në vend reflektohet në një numër të vendeve që kanë qarkullim të konsiderueshëm të remitancave nga jashtë. Në Kosovë dhe në Bosnjë e Hercegovinë këto përbëjnë mbi 11% përkatësisht 12.6 % të BPV-së. Derisa këto remitanca e balancojnë deficitin e vazhdueshëm tregtar dhe konsumin e karburanteve, ato e zvogëlojnë gjithashtu stimulimin për punë.

Siguria ligjore, një sistem gjyqësor funksional i pavarur për të zbatuar të drejtat themelore, përfshirë të drejtat pronësore, një administratë publike funksionale dhe zbatim unik i rregullave janë gjithashtu parakushte për tërheqje të investitorëve dhe për stimulim të zhvillimit ekonomik dhe për hapje të vendeve të punës. Dobësitë në sundimin e ligjit, në zbatimin e rregullave të konkurrencës, në menaxhimin e financave publike dhe në ndryshimet e shpeshta të lejeve dhe të taksave e shtojnë rrezikun për korrupsion, duke ndikuar negativisht në klimën për investime. Ballkani Perëndimor vuan nga niveli i ulët i industrializimit dhe nga shkalla e ulët e prodhimit të ndërmarrjeve industriale ekzistuese dhe nga dobësitë në qeverisjen e sektorit industrial. Këta faktorë shpjegojnë përse investimet e huaja në Ballkanin Perëndimor mbeten modeste. Kjo e pengon aplikimin e domosdoshëm të përvojave dhe njohurive më të mira, rrjedhimisht edhe zhvillimin më të shpejtë të prodhimit të prodhimit.

Zhvillimet dhe projektimet më të fundit ekonomike përfshijnë:

- Stabiliteti makroekonomik në vendet në zgjerim është ruajtur në masë të madhe, mirëpo sfida mbetet konsolidimi fiskal, sepse borxhi i lartë publik paraqet problem për një numër të vendeve.
- Vendet kandidatë të Ballkanit Perëndimor pritet të kenë rritje mesatare prej 2.5% në vitin 2015.
- Kjo shkallë e rritjes dhe zhvillimit, megjithatë, nuk mund të reflektohet në më shumë vende të punës. Papunësia në Ballkanin Perëndimor mbetet e lartë, posaçërisht në mesin e të rinjve dhe grave, e cila sillet mesatarisht rreth 22%, porse është shumë më e lartë në Bosnjë e Hercegovinë, në Kosovë dhe në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Nivelet e larta të varfërisë mbeten një shqetësim serioz.
- BE-ja është partneri kryesor tregtar i vendeve të Ballkanit Perëndimor, që merr pjesë me afër 60 % në eksportin e vendeve të rajonit. BE-ja gjithashtu është ofruesi më i madh i investimeve të huaja direkte.
- Në vitin 2014, Turqia ka pasur stabilizim së rritjes nga 2.9%, sa ishte një vit më parë, në 4.2%. Rritje paksa më e fuqishme parashikohet për vitin 2015. Lira turke është dobësuar dhe deficitin tregtar është ulur nga afër 8% të BPV-së në vitin 2014 në më pak se 6% në vitin 2015, duke reflektuar kështu në rritje më të ulët të kërkesës vendore dhe çmime më ulëta të energjisë elektrike. Performanca e fundit ekonomike e Turqisë e dëshmon si potencialin e lartë ashtu edhe mosbalancimin e vazhdueshëm të ekonomisë së saj.
- BE-ja mbetet partneri kryesor tregtar i Turqisë me mbi 40% të eksporteve të saj që shkojnë në BE. Turqia është bërë bazë e investimeve për bizneset evropiane me integrim në rritje të zinxhirit furnizues dhe prodhues të BE-së. Rreth 60% e investimeve të huaja direkte në Turqi vijnë nga BE-ja.



Duke u bazuar në përvojën e shteteve anëtare të BE-së në Semestrin Evropian, Komisioni po e shton përkrahjen e tij për të përmirësuar qeverisjen ekonomike dhe konkurrencën në vendet në zgjerim. Kjo do të duhej t'u ndihmonte vendeve në zhvillim që të lirojnë potencialin për zhvillim të qëndrueshëm, për krijim të vendeve të punës, për planifikim më të mirë, për aranzhim të reformave strukturore dhe, në fund të fundit, për të përmbushur kriteret ekonomike. Kjo përkrahje është posaçërisht e rëndësishme përse i përket vendeve të Ballkanit Perëndimor, pasi që asnjëri prej tyre ende nuk konsiderohet që të jetë ekonomi funksionale e tregut.

Në fillim të vitit 2015 të gjitha vendet në zgjerim kanë dorëzuar Programet për Reforma Ekonomike, duke adresuar si kornizën afatmesme makroekonomike ashtu edhe atë të politikave fiskale, si edhe reformat strukturore për vendet e Ballkanit Perëndimor. Në bazë të analizës së këtyre programeve nga Komisioni dhe të rekomandimeve të tij, në maj të vitit 2015, ministrat e Financave të BE-së dhe vendeve në zgjerim u takuan dhe miratuan rekomandime të përbashkëta për reformat që nevojiten për mbështetje të zhvillimit afatgjatë dhe të konkurrencës. Këto rekomandime reflektohen plotësisht në raportet themelore vjetore të Komisionit, të cilat ofrojnë udhëzime të mëtutjeshme për prioritetet e reformës. Financimi i IPA-s, gjithashtu, është duke u planifikuar më mirë.

Prej vitit të ardhshëm, Programet për Reforma Ekonomike do të paraqiten si një dokument i vetëm, i integruar, me fokus më të madh në punësim dhe në sfidat sociale. Hartimi i Programeve të Reformës Ekonomike do të vazhdojë për çdo vit.

Përse i përket Turqisë, ky vend dhe BE-ja kanë interes të përbashkët për promovimin e reformës ekonomike, shkëmbimin e përvojave, harmonizimin e qëndrimeve në G20 dhe thellimin e integritetit ekonomik. Komisioni ka bërë një vlerësim gjithëpërfshirës të ndikimit që do të fuqizojë mandatin për negociim për modernizimin dhe zgjerimin e Bashkimit të Doganave BE-Turqi. Kështu synohet që marrëdhëniet tregtare të avancohen në një nivel proporcional me rëndësinë strategjike të marrëdhënieve BE-Turqi dhe me rëndësinë e shkëmbimeve të tyre ekonomike. Do të nisë një dialog ekonomik i nivelit të lartë në mes BE-së e Turqisë, që do të shoqërohet me një forum të biznesit BE-Turqi dhe me një dialog të nivelit të lartë për energjinë.

Konkurrenca në rritje dhe masat e aplikuara për nxitjen e krijimit të vendeve të punës në rajon duhet të zvogëlojnë presionet e migrimit nga vendet në zgjerim drejt BE-së. Ngjashëm me situatën në të kaluarën, nevoja e mundshme dhe natyra për masa dhe mekanizma të përkohshëm mbrojtës për lëvizjen e lirë të punëtorëve do të adresohet gjatë negociatave të anëtarësimit për zgjerimin e ardhshëm, duke marrë parasysh vlerësimin e ardhshëm të ndikimit.

#### **d) Funksionimi i institucioneve demokratike dhe reforma e administratës publike**

Funksionimi si duhet dhe stabiliteti i institucioneve themelore që garantojnë demokracinë mbetet të adresohet në tërësi. Institucionet demokratike në një numër të vendeve mbeten të brishta. Mungon një kulturë e krijimit të kompromisit, me rol të parëndësishëm të parlamentit kombëtar. Gjatë periudhës së raportimit, në ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë, në Shqipëri dhe në Mal të Zi ka ndodhur bojkotimi i parlamentit nga opozita. Në Kosovë dhe në Mal të Zi deputetët e opozitës janë përfshirë në incidente të dhunshme kundër qeverisë. Shqyrtimi i hollësishëm parlamentar shpesh minohet nga përdorimi i tepruar i procedurave urgjente të miratimit të legjislacionit, nga sisteme dhe procedura të dobëta të komisioneve parlamentare dhe nga konsultimet e pamjaftueshme me palët e interesit dhe me përfshirje minimale të ekspertëve.

Ndonëse mbeten më pak çështje për t'u adresuar lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve të lira e të drejta, zgjedhjet, si të tilla, shpesh shihen si mundësi për të marrë kontrollin politik të institucioneve shtetërore. Reforma e administratës publike, e cila përfshi edhe profesionalizimin dhe depolitizimin e shërbimit civil, është kyçe në këtë drejtim.

Reforma e administratës publike, bashkë me sundimin e ligjit dhe qeverisjen ekonomike, është çështje ndërsektoriale me rëndësi themelore për sukses të reformave politike dhe ekonomike dhe për krijimin e bazës për zbatimin e standardeve dhe rregullave të BE-së.

Për qeverisje demokratike dhe për llogaridhënie nevojitet një administratë publike që funksionon mirë. Cilësia e administratës në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikon në aftësinë e qeverive që të ofrojnë shërbime publike, të parandalojnë dhe luftojnë korrupsionin dhe të nxisin konkurrencën dhe zhvillimin. Vendosja e parimeve të bazuara në meritë në menaxhimin e shërbimit civil dhe sigurimi i procedurave adekuate administrative janë thelbësore. Gjatë vitit të kaluar, në disa vende ka pasur përparim, por mbetet për t'u bërë akoma më shumë.

Vendet gjithashtu kanë nevojë të bëjnë një balancim të përshtatshëm ndërmjet qeverisë qendrore dhe qeverive rajonale dhe lokale. Ky balancim e përkrah më së miri zbatimin e reformave dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët. Autoritetet rajonale dhe lokale kanë gjithashtu rol substancial në procesin e anëtarësimit në BE dhe në zbatimin eventual të rregullave të BE-së.

Qytetarët, jo vetëm që kanë nevojë për administratë të mirë, por kanë të drejtë edhe të përfshihen aktivisht në bërjen e politikave. Duhet të bëhet më shumë për rritjen e pjesëmarrjes në procese demokratike dhe për zhvillimin e dialogut mes vendimmarrësve dhe palëve të interesit. Një shoqëri civile e fuqizuar është komponent jetik e çfarëdo sistemi demokratik. Ajo e avancoi llogaridhënien politike dhe kohezionin social, duke thëlluar të kuptuarit dhe gjithëpërfshirjen e reformave që kanë të bëjnë me anëtarësimin, si edhe mbështetjen për pajtim të shoqërive të ndara, si pasojë e konfliktit.

Në disa raste, nevojitet zhvillimi i një mjedisi më përkrahës dhe më lehtësues që përmirëson kushtet për dialog politik dhe për kontribut të paanshëm në procesin e vendimmarrjes, të mbështetur nga të dhëna cilësore që ofrohen nga agjencitë e pavarura kombëtare të statistikave. Duhet të sigurohet pavarësia dhe efikasiteti i organeve kyçe, siç janë avokati i popullit dhe institucionet shtetërore të auditimit, kurse rekomandimet e tyre duhet të adresohen në mënyrë të përshtatshme.

### **III. BASHKËPUNIMI RAJONAL**

#### **a) Agjenda e lidhjes**

Lidhja është thelbi i përpjekjeve të Komisionit për të promovuar integrimin e këtyre vendeve ndërmjet vendeve veç e veç dhe integrimin e këtyre vendeve dhe BE-së. Përpjekjet e tilla shërbejnë gjithashtu për të shtyrë përpara perspektivën evropiane. Përmirësimi i lidhjes kërkon investime për përmirësim të infrastrukturës së transportit dhe të infrastrukturës energjetike, si edhe për zbatimin e masave “të buta” për hapjen e tregjeve, heqjen e barrierave për integrim dhe krijimin e një mjedisi rregullativ transparent.

Lidhja e përmirësuar brenda Ballkanit Perëndimor dhe me BE-në është faktor kyç për zhvillim dhe për hapje të vende të punës, pasi ajo e forcon konkurrencën mes vendeve, sjell përfitime të qarta për qytetarët në vendet që aspirojnë anëtarësimin në BE dhe hap mundësi për investitorët e BE-së. Agjenda e lidhjes është në ndërlidhje të ngushtë me qeverisjen ekonomike dhe

me Programet e Reformës Ekonomike, të hartuara nga vendet në zgjerim. Më tutje, agjenda e lidhjes kontribuon në ndërtimin e urave lidhëse në rajon, duke krijuar kështu marrëdhënie të mira fqinjësore dhe duke promovuar paqen dhe pajtimin.

Progres i rëndësishëm është duke u bërë në kontekstin e “Procesit të Berlinit” dhe në formatin e gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor, që po e përkrahë qasjen rajonale për përcaktimin e prioritetëve reale për projektet dhe investimet thelbësore të infrastrukturës së lidhjes, si dhe për inkurajimin e reformave të nevojshme. Në muajin gusht, në Vjenë, krerët e shteteve dhe qeverive të rajonit dhe të një numri të shteteve anëtare vlerësuan progresin dhe caktuan prioritetet për zhvillime të mëtejme infrastrukturore.

Në fushën e **transportit**, Samiti i Vjenës, është zgjeruar me marrëveshjen e vendeve të Ballkanit Perëndimor në prill të vitit 2015 për rrjetin themelor, dhe në qershor të vitit 2015 për zgjerimin e korridoreve themelore të tri rrjeteve transportuese trans-evropiane për Ballkanin Perëndimor. Vendet i kanë identifikuar projektet me prioritet të pjesëve të këtyre korridoreve që do të zbatohen deri në vitin 2020. Për të siguruar qëndrueshmërinë dhe për të arritur rezultate afatshkurta të këtyre projekteve, vendet janë dakorduar që para samitit të radhës, në Paris, në verë të vitit 2016, të zbatojnë një numër të masave të buta, siç janë harmonizimi dhe thjeshtimi i procedurave në vendkalimet kufitare, siguria në rrugë dhe skemat e mirëmbajtjes së rrugëve. Kjo do të përkrahët edhe përmes finalizimit të Traktatit të Komunitetit të Transportit që do të promovojë integrimin e tregjeve, integrimin e infrastrukturës së transportit tokësor dhe do t’u ndihmojë vendeve të Ballkanit Perëndimor që të zbatojnë standardet e BE-së në transportin tokësor.

Gjithashtu është identifikuar përzgjedhja e projekteve me prioritet në mesin e 35 projekteve të dakorduara me interes të Komunitetit të Energjisë (PIKE), posaçërisht interkonektorët e energjisë. Për më tepër, vendet janë pajtuar të ndërmarrin hapa për krijimin e tregut rajonal të energjisë elektrike. Masat që do të mundësojnë arritjen e rezultateve edhe në afat të shkurtër përfshijnë sigurimin e përputhshmërisë së plotë me kriteret ekzistuese ligjore në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, përfshirë fushat e shturjes, qasjes së palëve të treta dhe forcimit të pavarësisë së rregullatorit.

Sa i përket ndryshimeve klimatike, shtetet aspirante për anëtarësim duhet të kryejnë reforma të rëndësishme që konsistojnë me kornizën BE2030 për politikën klimatike dhe të energjisë si dhe me zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare lidhur me çështje klimatike.

Projektet e identikuara për investime do të kërkojnë financim dhe bashkë-financim të rëndësishëm, përfshirë edhe financimin përmes Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor, me qëllim të mbështetjes së investimeve që rrisin zhvillimin e vendet e punës dhe promovojnë lidhjen në rajon. Koordinimi me institucionet financiare ndërkombëtare (INF) është duke u forcuar. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë themeluar komitetet kombëtare për investime, të cilat kanë hartuar një projekt-propozim të përbashkët për gazsjellësin, i cili duhet të bëhet mekanizëm i besueshëm për planifikimin dhe caktimin e prioritetëve për të siguruar se vendet kanë burime buxhetore dhe hapësirë fiskale për të marrë huatë e nevojshme financiare për t’i zbatuar me kohë të gjitha projektet.

**Të rinjtë dhe arsimit** është një prioritet tjetër. Komisioni e mirëpret marrëveshjen për “Axhendën pozitive për të rinjtë në Ballkanin Perëndimor” dhe Marrëveshjen për platformën e Ballkanit Perëndimor për Arsim dhe Trajnim për njëmbëdhjetë projekte rajonale që kanë për synim mbështetjen e reformave dhe rritjen e kapaciteteve. Nismat në kuadër të programeve Erasmus+ do të promovohen edhe më tutje, duke përfshirë “dritaren” (mundësinë) specifike të të rinjve, si edhe ndërmarrësinë. Komisioni gjithashtu e përkrah punën e Këshillit për Bash-

këpunim Rajonal me vendet aspirante për anëtarësim lidhur me njohjen e ndërsjellë të diplomave, gjë që do ta përmirësonte qarkullimin rajonal dhe do t'i bënte më efikase tregjet e punës.

**Integrimi** i mëtutjeshëm i **tregut** është një tjetër prioritet për rajonin. Përmes Zonës së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) janë eliminuar tarifatat dhe kuotat për prodhimet bujqësore dhe industriale. Kufizimet në qarkullimet tregtare ndër-rajonale, në masë të madhe, janë si pasojë e bizneseve jokonkurrese. Në Programet e Reformës Ekonomike, vendet në zgjerim kanë identifikuar masa të posaçme të konkurrencës, të cilat ia kanë dërguar Komisionit Evropian, në janar të vitit 2015. Por, do të ishte e rëndësishme që të bëhet kombinimi i duhur i stimulimeve të bizneseve, në mënyrë që të shmanget dëmtimi i konkurrencës së tatimeve. Komisioni do të bëjë një studim krahasues për stimulimet e bizneseve.

Në fushën e **TIK-ut dhe komunikimeve elektronike**, tregu unik digjital i BE-së duhet të shihet si model për vendet në zgjerim që të sigurojnë qasje më të mirë për konsumatorët dhe bizneset në pajisjet dhe shërbimet digjitale; që të krijojnë kushtet e duhura dhe shanset e barabarta për përparimin e rrjeteve digjitale dhe të shërbimeve inovative dhe të maksimizojnë potencialin zhvillimor të ekonomisë digjitale. Këshilli për Bashkëpunim Rajonal dhe vendet në zgjerim, përmes nismës e-SEE, tashmë kanë filluar të punojnë rreth bashkëpunimit konkret në këtë fushë, siç është zona pa roaming në Ballkanin Perëndimor.

Komisioni e mbështet plotësisht punën e Procesit të Bashkëpunimit të Evropës Juglindore dhe KRB-së, përfshirë strategjinë Rajonale 2020 dhe fokusin e saj në mbështetjen e bashkëpunimit dhe zhvillimit ekonomik në rajon. Komisioni e mirëpret intensifikimin e punës së nismës Ballkani Perëndimor Gjashtë, e cila e ka përkrahur gjithashtu fokusin për lidhje në kuadër të Procesit të Berlinit.

Komisioni do të vazhdojë të mbështesë punën në këto fusha dhe, bashkë me vendet e Ballkanit Perëndimor, do të eksplorojë fushat e reja të bashkëpunimit. Kjo do të përfshijë praktikatat më të mira të BE-së për përcaktimin e prioriteteve rajonale, siç është Strategjia e Specializimit Smart, e cila mund të inkurajojë investime të mëtutjeshme në hulumtime e inovacione dhe në arsim e trajnim profesional.

## **b) Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimi rajonal**

Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimi rajonal janë elemente themelore të proceseve të stabilizimit asociimit dhe të zgjerimit, të cilat vazhdojnë ta nxisin transformimin dhe të vendosjen e stabilitetit në vendet e Evropës Jug-lindore që aspirojnë anëtarësimin në BE. Ka pasur kontakte dhe bashkëpunim të intensifikuar, në nivelin bilateral dhe rajonal, në fushat e ndjeshme, siç janë: krimet e luftës, kthimi i refugjatëve, krimi i organizuar dhe bashkëpunimi policor. Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë vazhdojnë të forcohen përmes nismave të ndryshme të bashkëpunimit rajonal. Kontaktet rajonale në nivel kryeministrash dhe ministrash gjithashtu kanë qenë gjithnjë e më të shpeshta. Është e rëndësishme që këto nisma të jenë komplementare e gjithëpërfshirëse dhe të burojnë dhe të udhëhiqen nga rajoni. Në muajin gusht, janë nënshkruar marrëveshjet për kufijtë mes Malit të Zi dhe Bosnjës e Hercegovinës dhe Malit të Zi e Kosovës. Duhet të vazhdojë bashkëpunimi rajonal për çështjet mjedisore, me vëmendje të posaçme në parandalimin e vërshimeve dhe të çështjeve të ujit (pellgjet ujore ndërkuftare), ndotjes së ajrit dhe mbrojtjes së natyrës (zonat e mbrojtura ndërkuftare).

Njëkohësisht, nevojiten përpjekje të mëtutjeshme për tejkalimin e kontesteve bilaterale mes vendeve në zgjerim dhe me shtetet anëtare. Shumë çështje të pazgjidhura vazhdojnë t'i rëndojnë marrëdhëniet bilaterale në rajon, posaçërisht ato që janë krijuar nga shpërbërja e ish Ju-

gosllavisë, siç janë kontestet ndëretnike dhe kontestet për statusin dhe pozitën e minoriteteve, llogaridhënia për krimet e luftës, për personat e zhvendosur, për personat e zhdukur dhe për demarkacionin e kufirit. Pajtimi dhe lidhshipi i përgjegjshëm politik janë thelbësore për të promovuar stabilitetin dhe për të përkrahur krijimin e një mjedisi të favorshëm në Evropën Juglindore për të tejkaluar trashëgiminë e kaluar, duke minimizuar kështu rrezikun që çështjet e hapura bilaterale të instrumentalizohen politikisht ose që të hapen konteste të reja. Në rajon duhet t'u jepet përkrahje më e madhe përpjekjeve për pajtim, siç është nisma për të vërtetën dhe për pajtim e Koalicionit për Komisionin për Pajtim (KOMRA).

Çështjet bilaterale duhet të adresohen nga palët e përfshira sa më parë që të jetë e mundur dhe nuk duhet ta vonojnë procesin e anëtarësimit, i cili duhet të bazohet në kushtëzimin e përcaktuar. Komisioni i inkurajon palët që të bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur kontestet e mbetura në harmoni me parimet dhe mjetet e përcaktuara, përfshirë edhe referimin e çështjeve të Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë apo organeve tjera ekzistuese ose *ad hoc* për zgjidhjen e kontesteve, kur kjo është e përshtatshme. Klima pozitive e Samitit të Vjenës – ku liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor nënshkruan një marrëveshje ku u zotuan të mos e pengojnë progresin e njëra-tjetrës drejt BE-së dhe të shfrytëzojnë arbitrazhin ndërkombëtar kurdo që çështjet bilaterale nuk mund të zgjidhen nga palët e përfshira – është i mirëseardhur dhe duhet të zhvillohet më tutje.

Është bërë progres i rëndësishëm në procesin e normalizimit të marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës, me nënshkrimin e marrëveshjeve tjera të rëndësishme, në muajin gusht. Ky proces duhet të përcillet me zbatimin e të gjitha marrëveshjeve (përfshirë Marrëveshjen e Brukselit<sup>3</sup>). BE-ja e ka integruar kërkesën për normalizim të marrëdhënieve në kornizën e negociatave për anëtarësim me Serbinë dhe në Marrëveshjen e Stabilizim Asocimit me Kosovën. Për sa i përket Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, ruajtja e marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë mbetet thelbësore, përfshirë zgjidhjen e negociuar dhe të pranueshme për të dyja palët të çështjes së emrit, nën patronazhin e OKB-së, zgjidhje që duhet gjetur pa vonesa të mëtutjeshme.

Komisioni do të vazhdojë të ofrojë përkrahje politike për të gjitha vendet e përfshira, për të gjetur zgjidhje për çështjet bilaterale sa më herët që të jetë e mundur dhe do të vazhdojë të përkrahë aktivisht përpjekjet në forume tjera për të gjetur zgjidhje.

Komisioni e mirëpret përkrahjen e **Turqisë** për rifillim e bisedimeve të udhëhequra nga OKB-ja për zgjidhje në Qipro. Tani është me rëndësi që në këto bisedime të ketë progres, sa më shpejt që të jetë e mundur. Në pajtim me qëndrimet e përsëritura të Këshillit dhe Komisionit të viteve të kaluara, tani është urgjente që Turqia të përmbushë obligimin e saj për zbatimin e plotë të Protokollit Shtesë dhe të bëjë progres drejt normalizimit të marrëdhënieve me Republikën e Qipros. Kjo mund të paraqesë momentum të ri për procesin e anëtarësimit. Komisioni gjithashtu inkurajon shmangien e çfarëdo lloj kërcënimi, burimi të mosmarrëveshjeve ose veprimi që dëmton marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe zgjidhjen paqësore të kontesteve. Komisioni nënvizon të gjitha të drejtat sovrane të shteteve anëtare të BE-së. Kjo përfshin, *inter alia*, të drejtën për marrëveshje bilaterale dhe për eksplorim dhe shfrytëzim të burimeve natyrore në pajtim me *acquis* të BE-së dhe të drejtën ndërkombëtare, përfshirë Konventën e OKB-së për Ligjin e Detit.

<sup>3</sup> Prill 2013 “Marrëveshja e parë e parimeve që rregullon normalizimin e marrëdhënieve”.

#### IV. KONKLuzionet dhe Rekomandimet

Bazuar në analizën e mësipërme dhe në vlerësimet e paraqitura në përmbledhjen për vendet në zgjerim, në Shtojcë, Komisioni parashtron këto **konkluzione** dhe **rekomandime**:

##### I

1. Politika e BE-së për zgjerim është një investim në **paqe, siguri dhe stabilitet** në Evropë. Ajo siguron mundësi më të mëdha ekonomike dhe tregtare me përfitime të dyanshme, si për BE-në ashtu edhe për shtetet që aspirojnë anëtarësim.
2. Vendet në zgjerim duhet të plotësojnë kriteret e ngritura në mënyrë që t'i bashkohen BE-së. Një proces pranimi rigoroz, i ndërtuar mbi një **kushtëzim** të drejtë dhe mbi **parimin e meritave**, është qenësor për kredibilitetin e politikës për zgjerim, për të ofruar stimulime për vendet në zgjerim që të ndjekin reformat e gjera dhe për të ofruar mbështetje për qytetarët e BE-së.
3. Sfidat me të cilat ballafaqohen vendet në zgjerim janë të tilla që asnjëri prej tyre nuk do të jetë në gjendje t'i bashkohet BE-së gjatë mandatit aktual të Komisionit. Kjo nënvizon nevojën për të ripohuar fokusimin e vendosur për parimin **“çështjet fundamentale në rend të parë”** në procesin e pranimi, që do të jetë **shtylla kryesore e politikës për zgjerim** në kuadër të këtij Komisioni.
4. Në pajtim me këtë, Komisioni do të vazhdojë të fokusohet në përpjekjet e tij për të siguruar që vendet i prioritetizojnë reformat në fushën e **sundimit të ligjit**, përfshirë reformën gjyqësore dhe adresimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit, në **të drejtat themelore**, përfshirë lirinë e shprehjes dhe luftimin e diskriminimit, në mënyrë të veçantë ndaj komunitetit LGBTI dhe rom, dhe funksionimin e institucioneve demokratike, përfshirë **reformën e administratës publike**. Komisioni do të punojë po ashtu në promovimin e **zhvillimit ekonomik** dhe në fuqizimin e konkurrencës.
5. **Çështjet fundamentale janë të pandashme dhe të fuqizuara dyanshëm.** Fuqizimi i sundimit të ligjit rrit sigurinë ligjore, inkurajon dhe mbron investimet dhe kontribuon dukshëm në mbështetjen e zhvillimit ekonomik dhe të konkurrencës. Është e domosdoshme që procesi i zgjerimit të lehtësojë këto sinergji, në mënyrë që të sigurojë një shtysë më të fortë për reformat ekonomike, ashtu që shtetet anëtare aspiruese të gëzojnë të mirat e ekonomive funksionale të tregut me sundim të ligjit, para se ato t'i bashkohen dhe të kontribuojnë në funksionimin e mirë të Unionit, si tërësi.
6. Ballkani Perëndimor dhe Turqia kanë qenë të prekura rëndë nga **kriza e refugjatëve**, ku Turqia ka luajtur një rol të veçantë në ofrimin e mbështetjes humanitare për refugjatët. Kërkohej urgjentisht rritje e bashkëpunimit më të gjerë në rajon për të adresuar këtë fenomen, në mënyrë që të identifikohen personat që kanë nevojë për mbrojtje, për të siguruar ndihmë, për të siguruar kufijtë e jashtëm të BE-së dhe për të shpërbërë rrjetet kriminale të kontra-

bandimit të njerëzve. BE-ja po ofron mbështetje të madhe në këtë drejtim. Për më tepër, Komisioni ka propozuar që në listën e BE-së të vendeve të treta të sigurta të përfshihen të gjitha vendet në zgjerim.

7. Perspektiva e qartë e anëtarësimit në BE për Ballkanin Perëndimor është një faktor i rëndësishëm stabiliteti rajonal, ku kërkohen përpjekje të vazhdueshme për të tejkaluar trashëgiminë e së kaluarës dhe për të forcuar pajtimin. **Marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë dhe bashkëpunimi rajonal** janë elemente esenciale të Procesit të Stabilizim Asociimit dhe progresi i mirë është bërë në të kaluarën.
8. Komisioni po ofron mbështetje të fuqishme për **agjendën e lidhjes**, në ç’drejtim është parë një përparim i rëndësishëm në Samitin e Vjenës, në muajin gusht. Është arritur marrëveshje për rrjetin kryesor të transportit dhe tani mbetet të implementohen projektet kryesore të transportit dhe energjisë. Komisioni do të vazhdojë ta mbështesë këtë proces, përfshirë këtu një financim më të madh në kuadër të Asistencës së Instrumentit të Para-Anëtarësimit.
9. Ky Komision paraqet një **strategji gjithëpërfshirëse afatmesme të politikës së BE-së për zgjerim**. Komisioni do të vazhdojë të pranojë komunikimet vjetore për të vlerësuar progresin, për të nxjerrë konkluzionet dhe për të dhënë rekomandimet për çështjet tematike për vendet, sipas nevojës.
10. Komisioni ka prezantuar një strategji të re, të fuqizuar lidhur me vlerësimet e saj në **raportet vjetore të vendeve** në baza pilot në një numër fushash kryesore të reformimit. Përveç raportit të progresit, theks i veçantë i është vënë nivelit aktual të përgatitjes së vendeve në zgjerim për të marrë obligimet e anëtarësimit dhe ofrimit të udhëzimeve për adresimin e reformave në këto vende. Kjo do të rrisë transparencën, duke lehtësuar një përcjellje më të mirë të procesit të reformimit nga të gjitha palët e interesit, përfshirë shoqërinë civile, së cilës duhet t’i krijohet një hapësirë me më shumë mundësi. Vlerësimet më të harmonizuara po ashtu rrisin krahasueshmërinë në mes të vendeve.

## II

11. **Mali i Zi:** Negociatat për pranimit midis BE-së dhe Malit të Zi kanë përparuar. Korniza ligjore për sundimin e ligjit është përmirësuar dhe institucionet e reja janë duke u krijuar. Tani është qenësore për procesin e negociimit në përgjithësi që i tërë sistemi i sundimit të ligjit në Mal të Zi të arrijë rezultate, në veçanti në krijimin e një regjistri të rasteve të luftimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Progresi në përmbushjen e standardeve të përkohshme në kapitujt për sundimin e ligjit dhe mungesat tjera të identifikuara, të cilat dëshmojnë përmes rezultateve të prekshme, do të përcaktojnë dinamikën e negociatave për pranimit në përgjithësi. Të gjitha partitë politike tani duhet të tregojnë përgjegjësi dhe të rivendosin një dialog konstruktiv në parlament, si forum kryesor i debatit politik. Po ashtu, Mali i Zi duhet të sigurojë implementimin e plotë të legjislativës së ri zgjedhor. Mali i Zi duhet të zvogëlojë borxhin e tij publik dhe të përmirësojë konkurrencën për produktet industriale dhe bujqësore.

**12. Serbia:** Serbia ka ndërmarrë hapa të mëdhenj që duhet të shpjen në hapjen e kapitujve të parë të negociatave për praninë në BE. Ajo ka përfunduar planet gjithëpërfshirëse të veprimtari në fushën e sundimit të ligjit. Po ashtu, ka arritur një numër marrëveshjesh me Kosovën, të cilat paraqesin një arritje të rëndësishme në procesin e normalizimit të marrëdhënieve. Rrjedha e përgjithshme e negociatave do të varet sidomos nga progresi i qëndrueshëm në këto dy fusha. Komisioni pret hapjen e kapitujve të parë të negociimit në një Konferencë Ndër-qeveritare (IGC) këtë vit. Sundimi i ligjit, reforma e gjyqësorit dhe luftimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar do të jenë fushat kryesore. Procesi i reformave ekonomike duhet të vazhdojë, me theks të veçantë ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe atyre publike. Roli gjithnjë e më i madh udhëheqës dhe konstruktiv i Serbisë në rajon është i rëndësishëm për përmirësimin e lidhjeve dhe stabilitetit rajonal. Serbia është shumë e prekur nga kriza e refugjatëve dhe ka menaxhuar fluksin e mbi dyqind mijë personave nga vendet e treta që kanë kaluar përmes territorit të saj, prej fillimit të vitit.

**13. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë:** Procesi i pranimit të ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë në BE mbetet pa rrugëdalje. Demaskimet në kontekst të rasteve të përgjimeve kanë vërtetuar shqetësimet e mëhershme serioze të Komisionit dhe të tjerëve lidhur me ndërhyrjen politike në gjyqësor dhe në media, duke rritur kështu politizimin e institucioneve shtetërore dhe mbajtjen e zgjedhjeve. Njëkohësisht, vendi ka arritur një nivel të lartë përfarimi me *acquis* lidhur me pozicionin e tij në procesin e pranimit. Akterët politikë tani duhet të koncentrohen plotësisht në implementimin e “Prioriteteve urgjente të reformimit” të Komisionit dhe në tejkalimin e krizës politike. Buxheti duhet të orientohet më shumë në rritjen ekonomike dhe në punësim, ndërsa planifikimi i përgjithshëm buxhetor dhe transparencja e implementimit të tij duhet të përmirësohen. Është shumë e rëndësishme të ndërmerren hapa vendimtarë për zgjidhjen e “çështjes së emrit”. Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë është prekur rëndë nga kriza e refugjatëve, e cila ka menaxhuar një fluks prej më shumë se dyqind mijë personash nga vendet e treta gjatë kalimit përmes territorit të saj, prej fillimit të këtij viti. Varësisht nga vlerësimi i progresit të arritur në implementimin e marrëveshjes politike të Qershorit/Korrikut, Komisioni është i përgatitur të japë rekomandimet e tij për hapjen e negociatave për praninë në BE me ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Megjithatë, kjo do të kushtëzohet me vazhdimin e implementimit të marrëveshjes politike të Qershorit/Korrikut dhe me progresin e konsiderueshëm në implementimin e prioriteteve urgjente të reformave. Kjo çështje do të adresohet përsëri, pas zgjedhjeve.

**14. Shqipëria:** Shqipëria ka shënuar progres të qëndrueshëm në adresimin e prioriteteve kryesore për hapjen e negociatave për praninë, në veçanti në reformën e administratës publike dhe në përgatitjet për një reformë të plotë të sistemit gjyqësor. Tani është i nevojshëm miratimi i pakos së reformës së gjyqësorit si dhe i progresit të mëtejshëm sa i përket krijimit të regjistrit të hetimeve aktive, ndjekjeve dhe dënimeve të të gjitha të rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Miratimi i legjislationit për përjashtim nga parlamenti të kryesve të veprave penale do të rriste besimin e qytetarëve ndaj përfaqësuesve të tyre politikë dhe ndaj institucioneve publike. Për qëndrueshmërinë e procesit të integritetit në BE, duhet të vendoset një dialog politik ndër-partiak konstruktiv. Nevojiten përpjekje të mëtejshme për të mbajtur konsolidimin fiskal, për të përmirësuar mjedisin për biznes dhe për të trajtuar ekonominë joformale.



**15. Bosnja dhe Hercegovina:** Bosnja dhe Hercegovina ka hyrë në rrugën e reformimit, që është i nevojshëm për të vazhduar përpara drejt procesit të integritimit në BE. Progresi i rëndësishëm i arritur në implementimin e Agjendës së Reformave, të miratuar me konsensus politik, në muajin korrik, është i nevojshëm për BE-në, në mënyrë që të konsiderojë aplikimin e Bosnjës dhe Hercegovinës për anëtarësim. Zotimet me shkrim tani duhet të konkretizohen me miratimin dhe implementimin e reformave të nevojshme, në veçanti në fushën e sundimit të ligjit, përfshirë luftimin e korrupsionit dhe krimin të organizuar, si edhe reformave sociale e ekonomike. Për të adresuar shkallën e lartë të papunësisë dhe pjesëmarrjen e vogël në tregun e punës, vendi duhet të zvogëlojë ngurtësinë e tregut të punës, përfshirë edhe zvogëlimin e raportit midis çmimit/sasisë si rezultat i tatimit (“tax wedge”). Dialogu i strukturuar në drejtësi duhet të jetë instrument për adresimin e mangësive të mbetura në gjyqësorin e Bosnjës e Hercegovinës. Fuqizimi i administratës publike, përmirësimi i bashkëpunimit në të gjitha nivelet dhe krijimi i një mekanizmi efektiv bashkërendues për çështjet e BE-së do të jetë gjithashtu i nevojshëm për vendin që të ballafaqohet me sfidat që e presin në rrugën drejt BE-së. Adaptimi i MSA-së për të marrë parasysh pranimin e Kroacisë në BE duhet të finalizohet si një çështje urgjente.

**16. Kosova:** Komisioni e mirëpret nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, e cila paraqet një kornizë gjithëpërfshirëse të marrëdhënieve më të afërta politike dhe ekonomike në mes BE-së dhe Kosovës. Vendimi i Kosovës për të themeluar Dhomat e Specializuara për t’u trajtuar krimet e rënda të kryera gjatë konfliktit në Kosovë përbën një hap të rëndësishëm përpara. Ajo, po ashtu, ka arritur disa marrëveshje me Serbinë, të cilat paraqesin një arritje të rëndësishme në procesin e normalizimit të marrëdhënieve. Kosova duhet të shfrytëzojë momentumin pozitiv, përfshirë adresimin e një numri sfidash të reformave, në veçanti për sundimin e ligjit dhe për luftimin e krimin të organizuar dhe korrupsionit. Është nevojë urgjente që Qeveria dhe Kuvendi të sigurojnë që pa vonesë dhe në bazë të meritës, të emërohen anëtarët e bordeve të shumë institucioneve të pavarura dhe autoriteteve rregullatore. Komisioni e mirëpret progresin e shënuar drejt përbushjes së kërkesave të procesit të liberalizimit të vizave. Kosova ka ndërmarrë disa masa afatshkurtra efektive për të mbajtur nën kontroll migrimin jo të rregullt për në BE. Kuvendi duhet të lejohet të zhvillojë debat të lirë dhe të hapur për të gjitha çështjet që prekin Kosovën, në pajtim me procedurat demokratike. Pengimi i kuvendit dhe dhuna për qëllime politike nuk janë të pranueshme.

**17. Turqia:** Turqia është partner kryesor i Bashkimit Evropian. Gjatë vitit të kaluar, BE-ja dhe Turqia kanë vazhduar të rrisin bashkëpunimin në fushat kryesore të interesit të përbashkët. Turqia po ballafaqohet me çështje serioze të sigurisë dhe politikës së huaj, përfshirë rritjen e kërcënimit nga terrorizmi. Turqia, po ashtu, është në ballë të një krize të madhe të refugjatëve dhe po ofron mbështetje të konsiderueshme për më shumë se 2 milionë refugjatë sirianë në territorin e saj. Rritja e dialogut politik, bashkëpunimi dhe partneriteti mes BE-së dhe Turqisë është qenësor. Këshilli i Evropës e ka mirëpritur Planin e Përbashkët të Punës për menaxhimin e migrimit dhe refugjatëve, si pjesë e një agjende gjithëpërfshirëse të bashkëpunimit, bazuar në ndarjen e përgjegjësisë, zotimeve dhe angazhimeve të përbashkëta. BE-ja dhe shtetet anëtare të saj kanë shprehur gatishmërinë për të rritur bashkëpunimin me Turqinë dhe për të përsheptuar qëndrueshmërinë e tyre politike dhe financiare, në kuadër të kornizës së përcaktuar. Implementimi i suksesshëm i Planit të Përbashkët të Veprimit do të kontribuojë në përsheptimin e përbushjes së udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave drejt të gjitha shteteve anëtare pjesëmarrëse dhe drejt implementi-

mit të plotë të marrëveshjes për riatdhesim. Progresi do të vlerësohet në pranverën e vitit 2016, kur edhe Komisioni do ta publikojë raportin e dytë për liberalizimin e vizave. Megjithatë, progresi i Turqisë në reforma është ngadalësuar për shkak të përsëritjes së zgjedhjeve dhe konfrontimeve politike. Mangësitë e konsiderueshme e kanë prekur gjyqësorin, situata lidhur me lirinë e shprehjes dhe lirinë e medias ka vazhduar të përkeqësohet. Procesi i rregullimit të çështjes së kurdëve është ndërprerë. Sa i përket përafrimit me *acquis* të BE-së e më gjerë, Turqia ka arritur një nivel të mirë përgatitjesh në shumë fusha. Turqia është një ekonomi tregu funksionale, me rritje ekonomike mesatare, mirëpo ka ende nevojë të adresojë çekuilibrin makroekonomik dhe të bëjë reforma të mëtejshme strukturore. BE-ja dhe Turqia kanë intensifikuar punën për të rritur profilin e marrëdhënieve të përbashkëta ekonomike dhe tregtare, përmes mbështetjes së parimeve të modernizimit dhe zgjerimit të Bashkimit Doganor dhe përmirësimit të dialogut lidhur me politikën në sektorin e energjisë. BE-ja është e gatshme që të riangazhohet me Turqinë për një spektër të gjerë të çështjeve të agjendës së përbashkët. Turqia duhet të rirforcojë reformat në fushën e sundimit të ligjit dhe të drejtave themelore. Është e domosdoshme që bisedimet për paqetë rifillojnë pa vonesë. Komisioni pret që në këto prioritete kryesore të punojë me qeverinë e re, të dalë nga zgjedhjet e 1 nëntorit. Këshilli i Evropës ka nxjerrë si përfundim se procesi i pranimit duhet të rifuqizohet me synim që të arrihet progres në negociatë, në pajtim me kornizën negociuese dhe me konkluzionet përkatëse të Këshillit. Komisioni ka propozuar hapjen e Kapitullit 17 dhe thirrjet e Këshillit për organizimin e një konference ndër-qeveritare para përfundimit të vitit 2015. Një raport i përditësuar pasqyrimi për Kapitullin 31 është dorëzuar në dhjetor 2013. Komisioni do ta rishikojë progresin në kapitujt tjerë dhe planifikon të dorëzojë dokumentet e përditësuara përgatitore për Kapitujt 15, 23, 24, 26 deri në pranverë të vitit 2016. Pastaj, në Këshill mund të nisnin diskutimet për të gjithë këta kapituj, pa paragjykuar qëndrimin e shteteve anëtare. Në veçanti, përgatitjet për rilansim drejt hapjes së kapitujve 23 dhe 24 do t'i siguronin Turqisë një udhërrëfyes gjithëpërfshirës për reforma në fushat esenciale të sundimit të ligjit dhe të të drejtave themelore. Në pajtim me qëndrimet e përsëritura të Këshillit dhe të Komisionit të viteve të mëparshme, tani është urgjente që Turqia t'i përmbushë obligimet e saj për implementimin e plotë të Protokollit Shtesë dhe të arrijë progres në normalizimin e marrëdhënieve me Republikën e Qipros. Komisioni e mirëpret rifillimin e bisedimeve për zgjidhjen e çështjes së Qipros, të udhëhequra nga OKB-ja. Tani është e rëndësishme sa më shpejt që të jetë e mundur të shënohet progres në këto bisedime. Angazhimi dhe kontributi konkret i Turqisë është qenësor për një rregullim gjithëpërfshirës të çështjes së Qipros. BE-ja e ka deklaruar gatishmërinë e saj për të përshtatur kushtet për rregullim në pajtim me parimet mbi të cilat është themeluar Unioni.

## **V. SHTOJCAT**

1. Përmbledhjet e të gjeturave në raportet e vendeve
2. Ndryshimet në raportet vjetore për vendet
3. Statistikat kryesore

## Mali i Zi

Për sa i përket **kritereve politike**, legjislacioni i ri zgjedhor, i miratuar në vitin 2014, duhet të zbatohet plotësisht, duke përfshirë identifikimin elektronik të votuesve. Nuk ka pasur vazhdimësi në lidhje me pretendimet për shpërdorime të fondeve publike për qëllime të partive politike (“afëra e audio incizimeve”).

Disa parti opozitare filluan bojkotin e parlamentit në shtator. Një numër protestash gjithashtu janë organizuar jashtë ndërtesës së parlamentit. Këto përfundimisht quan në konfrontim në mes të policisë dhe protestuesve, që rezultuan me të lënduar dhe dëmtime të pronës. Pritshmëritë janë që të gjitha incidentet e dhunës dhe pretendimet për përdorim të tepruar të forcës gjatë këtyre ngjarjeve do të hetohen siç duhet. Në të njëjtën kohë, të gjitha partitë politike duhet të angazhohen përsëri në dialog konstruktiv politik në parlament.

Ka pasur pak progres në përmirësimin e bashkëpunimit në mes të qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile, veçanërisht në lidhje me pjesëmarrjen e këtyre të fundit në procesin e pranim-it, ku shoqëria civile vazhdon të ketë një rol aktiv. Kushtet për udhëheqjen e punës vullnetare, aktivizimit qytetar dhe ndërmarrësisë shoqërore duhet të krijohen.

Për sa i përket reformës në administratën publike, Mali i Zi është mesatarisht përgatitur. Mirëpo, rezultatet në sigurimin e punësimit të bazuar në merita dhe përpjekjet për ndaluar politizimin janë të pabarabarta; kjo duhet të garantohet për të gjitha nivelet, përfshirë këtu pozitave të larta. Në lidhje me menaxhimin e financave publike, Mali i Zi duhet të ngritë standardet e kontabilitetit në nivelin e standardeve ndërkombëtare dhe të vendosë kornizë të fortë të kontrollit të brendshëm dhe të përmirësojë përbushjen ligjore.

Sistemi gjyqësor është mesatarisht i përgatitur. Hapa të rëndësishëm janë ndërmarrë për të përafuar kornizën ligjore me standardet Evropiane, duke rritur profesionalizmin dhe pavarësinë. Një theks i veçantë tani duhet të jetë në zbatim. Në vitin 2014, numri i lëndëve të pazgjidhura nuk është zvogëluar aq shumë. Kodet e etikës për gjyqtarë dhe prokurorë janë përafuar me standardet relevante Evropiane dhe ndërkombëtare. Ekziston strategjia për reformën gjyqësore (2014-2018) si dhe plani veprues që shoqëron këtë strategji. Tani kërkohet zbatimi i plotë i strategjisë së re për rekrutim, vlerësim dhe promovim profesional.

Sa i përket luftës ndaj korrupsionit, Mali i Zi ka arritur një nivel të caktuar të përgatitjes. Mirëpo, të dhënat për hetime, ndjekje penale dhe dënime përfundimtare efektive në rastet e korrupsionit, në veçanti në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë, mbeten të kufizuara, vendi ka një nivel të caktuar të përgatitjes. Përpjekje të mëtutjeshme janë të nevojshme, në veçanti për të hetuar rrjetet më të gjera kriminale dhe të luftimit të shpëlarjes së parave.

Progresi i mëtutjeshëm i negociatave për anëtarësim në përgjithësi do të varet gjithashtu nga progresi në sundimin e ligjit: kjo e fundit gjithashtu do duhet të demonstrohet, dhe vlerësohet, në bazë të të dhënave të besueshme në luftimin e korrupsionit dhe kriminit të organizuar.

Korniza ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut është në përputhje me standardet Evropiane, por problemet mbesin tek zbatimi. Mali i Zi ka arritur një nivel të caktuar të përgatitjes në fushën e lirisë së shprehjes. Mirëpo, shqetësimet mbesin: Ka pasur raste të sulmeve ndaj praktikuesve dhe pronave të mediave gjatë periudhës raportuese, megjithëse më të pakta se vitet e kaluara. Disa raste të dhunës ndaj mediave mbesin të tu zgjidhur, duke përfshirë rastin më serioz, atë të vrasjes së kryeredaktorit në vitin 2004. Mungesa e standardeve të forta profesionale dhe etike, e shoqëruar me mungesë të vetë-rregullimit efikas, nuk e avancojnë lirinë e mediave.

Mali i Zi ka vazhduar të luajë një rol konstruktiv në bashkëpunimin rajonal dhe ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në gjetjen e zgjidhjeve të pranueshme reciproke për çështjet bilaterale me vendet fqinjë, duke përfshirë nënshkrimin e marrëveshjeve për kufirin me Bosnje Hercegovinën dhe Kosovën në gusht.

Sa i përket **kritereve ekonomike**, Mali i Zi është mesatarisht i përgatitur për zhvillimin e ekonomisë funksionale të tregut. Pak progres ka pasur në ndjekjen e konsolidimit fiskal dhe përmirësimin të ambientit biznesor. Ekonomia u rimëkëmb në vitin 2013 nga recesioni i dyfishtë i vitit 2009 dhe 2012. Pas një ngadalësimi të butë në vitin 2014, rritja ekonomike po e arrin momentumin prapë, i shtyrë nga investimet. Përderisa ndërtimi i autostradës Bar-Boljare, së bashku me investimet tjera në energji, transport dhe turizëm, do të mbështesin rritjen ekonomike, kosto e autostradës rrezikon stabilitetin sfidues fiskal. Mali i Zi duhet të bëjë përpjekje për të zvogëluar borxhin publik. Bankat ballafaqohen vazhdimisht me nivele të larta të kredive me probleme (NPL), probleme me kthim të borxhit dhe profit të ultë për shkak të madhësisë së vogël të tregut, që rezulton në kredi të pakta dhe të shtrenjta. Pavarësisht përmirësimeve të vogla, tregu i punës mbetet i pakënaqshëm me vazhdimësi të nivelit të lartë të papunësisë, aktualisht 18%.

Mali i Zi është mesatarisht i përgatitur në kapacitetin e saj për tu përballë me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit. Megjithatë, për produkte industriale dhe bujqësore, Mali i Zi ende vuan nga konkurrenca e ultë, e cila duhet të përmirësohet. Reforma madhore ende janë të nevojshme për të forcuar infrastrukturën fizike të vendit dhe kapitalin njerëzor, dhe që të siguroj një ambient rregullator të parashikueshëm dhe mbështetës.

Sa i përket **zotësisë për të marrë obligimet e anëtarësimit**, Mali i Zi është mesatarisht i përgatitur për shumicën e kapitujve të *acquired* dhe pse niveli i përafrimit ndryshon. Mali i Zi është mesatarisht i përgatitur në lidhje me prokurimin publik. Punë e mëtutjeshme nevojitet për të parandaluar shfaqjen e korrupsionit gjatë ciklit të prokurimit. Në kontrollin financiar, Mali i Zi është mesatarisht i përgatitur por përpjekje të mëdha janë të nevojshme për të zbatuar kontrollin e brendshëm financiar publik (KBFP) në të gjitha nivelet e administratës publike dhe në ndërmarrjet shtetërore. Mali i Zi ka arritur pak në përgatitje në lidhje me statistikat: përpjekje të domethënëse janë të nevojshme, veçanërisht për të siguruar përafrimin e statistikave makro-ekonomike dhe biznesore me standardet e BE-së.

Mali i Zi është në fazën e hershme të përgatitjes për, *interalia*, ndryshimet klimatike dhe të ambientit. Përafrimi me *acquis* dhe fuqizimi i kapaciteteve administrative mbetet një sfidë e rëndësishme për Malin e Zi.

## Serbia

Për sa i përket **kritereve politike**, palët e interesit, përfshirë shoqërinë civile, kanë qenë gjithnjë e më shumë të përfshirë në procesin pranimit. Ndonëse bashkëpunimi në mes të autoriteteve dhe organeve të pavarura rregullatorë dhe Avokatit të Popullit është rritur kohëve të fundit, kjo duhet të përmirësohet edhe më tutje. Përdorimi i procedurave urgjente në parlament duhet të zvogëlohet. Reforma kushtetuese do të jenë të nevojshme për përafrim me standardet e BE-së në disa fusha.

Serbia është mesatarisht e përgatitur në fushën e reformës së administratës publike. Një progres i mirë është arritur me miratimin e planit të veprimit gjithëpërfshirës. Serbia duhet të mbetet e zotuar dhe të zbatojë shënjestrat e saj të reformave. Vullneti i fortë politik mbetet esencial për profesionalizimin dhe de-politizimin e administratës dhe për të bërë procedurat e rekrutimit dhe përjashtimit më transparente, veçanërisht për pozitat e larta menaxheriale.

Sistemi gjyqësor ka arritur një nivel të caktuar të përgatitjes. Rregullat e reja për vlerësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve janë miratuar në maj. Shumica e Kryetarëve të Gjykatave janë emëruar në baza të përhershme. Hapa të mëtutjeshëm janë të nevojshëm për të luftuar ndikimin politik. Cilësia dhe efikasiteti i gjyqësorit dhe qasja në gjyqësi janë vështirësuar nga shpërndarja e pabarabartë e ngarkesës së punës, raste të pazgjidhura të shumta dhe mungesë të sistemit të ndihmesës ligjore pa para.

Serbia ka pak përgatitje në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, që mbetet e shtrirë plotësisht. Përpjekjet anti-korrupsion ende pritet të tregojnë rezultate domethënëse. Organizimi institucional ende nuk është duke funksionuar si mbajtës i besueshëm. Kërkohen të dhëna gjurmuese për hetimet, ndjekjet penale dhe dënime efektive në rastet e korrupsionit, duke përfshirë ato të nivelit të lartë.

Serbia ka pak përgatitje në lidhje me luftimin e krimit të organizuar. Laboratorët e rinj për ADN dhe kimi të drogave janë bërë operacionale. Vendi në mënyrë aktive është duke kontribuar në bashkëpunime ndërkombëtare dhe rajonale. Serbia ka miratuar strategjinë për luftë ndaj shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit si dhe strategjinë për hetime financiare por ende i mungon një pasqyrim strategjik i situatës së krimit të organizuar në territorin e vet. Të dhëna të besueshme në luftimin e krimit të organizuar duhet të krijohen.

Korniza ligjore dhe institucionale për respektimin e të drejtave themelore është e vendosur. Zbatimi i qëndrueshëm në tërë vendin duhet të sigurohet, duke përfshirë mbrojtjen e minoriteteve. Më shumë duhet të bëhet për të siguruar kushte për ushtrim të plotë të lirisë së mediave dhe lirisë së shprehjes, ku Serbia ka arritur pak përgatitje. Përpjekje të qëndrueshme të mëtutjeshme janë të nevojshme për të përmirësuar situatën e Romëve dhe të refugjatëve dhe personave të zhvendosur. Autoritetet kanë ndërmarrë hapa në forcimin e mbrojtjes së të drejtave të personave lezbike, homoseksual, biseksual, transeksual dhe interseksual (LGBTI), dhe prapë ka ndihmuar paradën e krenarisë në Beograd. Mirëpo, një kulturë më e fortë dhe respekt për personat LGBTI ende është e nevojshme.

Serbia në mënyrë konstruktive ka marrë pjesë në nisura rajonale dhe ka punuar në përmirësimin e marrëdhënieve të saj bilaterale në shpirtin e pajtimit dhe marrëdhënieve të mira miqësore. Pjesëmarrja e Kryeministrit në përkujtimin e gjenocidit të Srebrenicës në Korrik ka dërguar një mesazh pozitiv.

Në lidhje me **normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën**, Serbia ka mbetur e zotuar në zbatimin e ‘Marrëveshjes së parë të parimeve qeverisëse të normalizimit të marrëdhënieve’ të prillit 2013 dhe marrëveshjeve tjera të arritura në dialogun e ndihmuar nga BE. Marrëveshjet kyçe janë finalizuar në gusht mbi energjinë, telekomin, themelimin e Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë Serbe si dhe Urën e Mitrovicës. Dialogu gjithashtu ka arritur edhe rezultate të mëtutjeshme konkrete në fushat e drejtësisë, integritit të mbrojtjes civile, sigurimit të makinave, të hyrave doganore dhe MIK. Gjithashtu ka pasur edhe diskutime konstruktive për përmirësimin e bashkëpunimit në luftimin e migrimit nga Kosova. Hapat e ndërmarrë kanë dhënë një momentum të ri në normalizimin e marrëdhënieve dhe duhet të kenë ndikim pozitiv dhe konkret në jetën e përditshme të qytetarëve në Kosovë dhe Serbi.

Për sa i përket **kritereve ekonomike**, Serbia është mesatarisht e përgatitur për zhvillimin e ekonomisë funksionale të tregut. Progres i mirë është arritur në adresimin e disa dobësive në politika dhe momentumit pozitiv i avancimit të reformës strukturale duhet të ruhet. Ekonomia e Serbisë po rimëkëmbet nga recesioni. Duke ju falënderuar masave domethënëse konsoliduese dhe mbledhjes më të mirë të tatimeve, deficitit buxhetor ka rënë shpejtë. Konsolidimi fiskal duhet të mbahet dhe të përforcohet duke zbatuar reformat siç është planifikuar. Inflacioni

mbetet shumë i ultë, duke lejuar bankën qendrore të zvogëloj kamatat. Papunësia, ndonëse shumë e lartë, ka rënë nën 20%. Ka pasur progres në ristrukturimin e ndërmarrjeve publike dhe shërbimeve kryesore komunale, por duhet të përparoj më tutje. Sektori privat është i nën-zhvilluar dhe penguar nga dobësitë në zbatim të ligjit dhe qasjes së vështirë në financa. Procesi i reformave ekonomike duhet të vazhdojë me theks të veçantë në ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore dhe shërbimeve publike.

Serbia është mesatarisht e përgatitur sa i përket kapaciteteve për tu përballë me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit. Sistemi arsimor mbetet i paaftë, struktura fizike e nën-zhvilluar dhe sektori joformal dhe ndihma nga shteti janë të konsiderueshme. Serbia ka nevojë të përmirësoj cilësinë në sistemin arsimor, të orientuar drejt nevojave të tregut të punës, nxisë investime private për të përshpejtuar zbatimin e projekteve infrastrukturore publike. Duhet të rregulloj më mirë pagesat para-fiskale dhe të sigurojë një kornizë transparente të mbështetjes shtetërore për sektorin privat, ridrejtuar drejt objektivave efikase dhe horizontale, siç janë mbështetja nga NVM-së dhe hulumtimit dhe zhvillimit.

Për sa i përket **zotësisë për të marrë obligimet e anëtarësisë**, Serbia ka vazhduar të bashkërendoj legjislacionin e saj në të gjitha fushat me *acquist* BE-së. Resurset adekuate financiare dhe njerëzore, si dhe korniza të fuqishme strategjike do të jenë vendimtare për mbajtjen e hapit të reformave. Legjislacioni i Serbisë tani është në masë të madhe i përafër në fushat si prona intelektuale, anti-besim dhe bashkim, dhe politika monetare. Serbia ka themeluar Komitetin Kombëtar të Investimeve, që bashkon në një vend autoritetet kombëtare, donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare (IFN) për të koordinuar politikën Serbe të investimeve në sektorët kyç në një linjë të vetme të projektit (energji, transport, ambient dhe infrastrukturë që lidhet me biznesin), që është një shembull për rajonin. Në fushat e prokurimit publik, statistikave dhe kontrollit financiar, Serbia është mesatarisht e përgatitur. Serbia do të duhet të bashkërendojë politikën e saj të jashtme dhe të sigurisë në mënyrë progresive me Politikën e Jashtme dhe të Sigurisë të Përbashkët të Bashkimit Evropian në periudhën deri në praninë.

Lëvizja e përzier e migracionit është rritur në mënyrë dramatike, duke krijuar një ngarkesë të konsiderueshme në kornizën Serbe të azilit dhe migracionit. Serbia ka bërë përpjekje të konsiderueshme që të sigurohet që nacionalitetet e vendeve të treta që kalojnë transit në vend të ketë strehim dhe furnizime humanitare, me mbështetje të BE-së dhe të të tjerëve gjithashtu. Në të njëjtën kohë, Serbia duhet të vazhdojë me përpjekjet për të adresuar aplikacionet e pabazuara për azil të depozituara nga shtetasit e Serbisë në BE dhe vendet e Schengenit, nga pikëpamja e mbrojtjes së regjimit të udhëtimit pa viza.

## **Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë**

Për sa i përket **kritereve politike**, sfidat serioze të raportuara në vitet e kaluara kanë shënuar rënie si pasojë e krizës më të rëndë politike të vendit që nga viti 2001 me komunikimet e përgjuara, që me sa duke përfshinë zyrtarë të lartë qeveritarë, duke sugjeruar shkelje të të drejtave themelore të njeriut, ndërhyrje në pavarësinë e gjyqësorit, liri të mediave dhe zgjedhje, si dhe politizim dhe korrupsion. Shqetësimet për të gjitha këto çështje ishin sinjalizuar në raportin e kaluar të Progresit. Shkatërrimi i dialogut politik dhe vështirësitë në arritjen e konsensusit mbi çështjet e kanë theksuar edhe një herë ndarjen në kulturën politike të vendit.

Bazuar në marrëveshjen e ndihmuar nga Komisioneri, me ndihmën e tre anëtarëve të Parlamentit Evropian, në qershor / korrik, Parlamentarët dhe partia kryesore politike u kthyen në parlament me 1 shtator pasi kishin bojkotuar atë për më shumë se një vit. Bojkoti seriozisht ka dëmtuar funksionin e mbikëqyrjes së institucionit ndaj ekzekutivit. Organet tjera kyçe dështuan

të ushtrojnë mbikëqyrje efektive. Ka filluar puna në zbatimin e marrëveshjes politike. Zbatimi duhet të vazhdojë dhe shumë më tepër duhet të bëhet në “Prioritetet e Reformës Urgjente”<sup>4</sup> që të japin rezultate në këto si dhe në shënjestrat e pajtuara të reformave që kanë ekzistuar.

Situata ndëretnike mbetet e brishtë. Rishikimi i Marrëveshje së Ohrit, e cila i dha fund konfliktit të vitit 2001 dhe që siguron një kornizë për marrëdhëniet ndëretnike, duhet të përfundojë.

Pas operacionit të madh policor në një lagje etnike Shqiptare në Kumanovë që morri jetën e 18 personave, të gjithë liderët politikë në vend bënë thirrje për rivendosje të qetësisë dhe theksuan që ky incident nuk duhet të shihet si ndëretnik. Ngjarjet në Kumanovë ende duhet të hetohen në tërësi.

Organizatrat e shoqërisë civile kanë luajtur një rol konstruktiv në kontekstin e krizës duke kërkuar përgjegjësi nga akterët politikë nga të gjitha etnitë. Në të njëjtën kohë organizatat vazhdojnë të shprehin shqetësimet e tyre rreth mjedisit të vështirë në të cilin veprojnë dhe zotimit të kufizuar të qeverisë për dialog, si dhe rreth sulmeve publike nga politikanët dhe mediat por-qeveritare.

Vendi është mesatarisht i përgatitur në fushën e reformave në administratën publike. Ka pasur progres në disa çështje. Megjithatë, shqetësimet rreth politizimit janë fuqizuar nga përmbajtja e përgjimeve, dhe rekrutimi i bazuar në merita vazhdon të dobësohet. Besimi i publikut mbi funksionimin e institucioneve është shkatërruar edhe më tutje. Janë marrë disa hapa për reformë në menaxhimin e financave publike, por korniza buxhetore dhe transparenca fiskale afatmesme ende kanë nevojë të vendosen dhe të përmirësohen.

Sistemi gjyqësor i vendit ka pasur pak përgatitje. Situata është kthyer mbrapa që nga viti 2014 sepse arritjet e procesit të reformës së dekadës së kaluar janë dobësuar seriozisht nga ndërhyrja ekzistuese dhe potenciale e politikës në punën e gjyqësorit. Treguesit e keqbërjes dhe shkeljet që janë ngritur nga komunikimet e përgjuara ende duhet të hetohen në tërësi. Autoritet tani duhet të demonstrojnë vullnet të vërtetë politik për të siguruar pavarësinë e plotë të sistemit gjyqësor, duke përfshirë lejimin e Prokurorit Special të sapo emëruar që të punoj pa pengesë në hetimin e përgjimeve dhe përmbajtjes së tyre.

Për sa i përket luftimit të korrupsionit, pak përgatitje është arritur. Arritjet legislative dhe institucionale megjithatë ishin errësuar nga mungesa e vullnetit politik dhe ndërhyrjes politike në punën e organeve relevante, veçanërisht në rastet e nivelit të lartë. Të dhënat mbi ndjekjet penale efektive, veçanërisht në korrupsion të nivelit të lartë, ende duhet të themelohen.

Në luftimin e krimit të organizuar, ka arritur pak përgatitje. Kapacitet dhe ekspertiza e mjaftueshme për të kryer hetime financiare dhe konfiskim të aseteve në mënyrë sistematike ende ka nevojë të themelohet.

Korniza ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut gjerësisht është e përafuar me standardet Evropiane. Mirëpo, mungon zbatimi, në veçanti në fushat e reformës së burgjeve, integritit të Romëve, të drejtat e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara. Komuniteti i lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transeksualëve dhe interseksualëve (LGBTI) vazhdon të vuaj nga diskriminimi dhe përmbajtjet homofobike në media. Vendi tregon pak përgatitje në lidhje me lirinë e shprehjes. Ushtrimi i kësaj lirie, prapëseprapë, është një problem serioz në kulturën aktuale të mediave dhe klimën politike, dhe vendi ka vazhduar që të ketë kthim mbrapa në këtë fushë. Përpjekjet për kufizimin e raportimit të mediave për çështjet me interes për publikun janë shqetësuese.

<sup>4</sup> “Prioritetet urgjente në reformism”:

[http://ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_urgent\\_reform\\_priorities.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_urgent_reform_priorities.pdf)

Rekomandimet e Grupit të ekspertëve të lartë:

[http://ec.europa.eu/enlargement/news\\_corner/news/news-files/20150619\\_recommendations\\_of\\_the\\_senior\\_experts\\_group.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf)



Vendi në përgjithësi mban marrëdhënie të mira me vendet e tjera të zgjerimit dhe luan një rol aktiv në bashkëpunimin rajonal. Janë ndërmarrë hapa në përmirësimin e marrëdhënieve të mira me fqinjët. “Çështja e emrit” me Greqinë duhet të zgjidhet urgjentisht.

Për sa i përket **kritereve ekonomike**, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë është në një nivel të mirë të përgatitjes për zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut. Vendi përfiton nga ambienti i qëndrueshëm makroekonomik, i mbështetur nga politika të shëndosha monetare, kushte të favorshme për të hyrë në treg, dhe një sistem të shëndoshë ligjor. Ka pasur pak kthim mbrapa në menaxhimin e financave publike. Shënjestrat fiskale afatmesme janë lehtësuar, përbërja e shpenzimeve publike mbetet e anuar drejt transferove dhe subvencioneve dhe zhvillimit të përgjithshëm të borxhit publik, si dhe transparencës së saj, mbesin një shqetësim. Buxheti duhet të jetë më shumë i drejtuar kah rritja dhe punësimi, përderisa dizajni i tij i përgjithshëm, transparenca dhe zbatimi duhet të përmirësohen. Një nivel i lartë i kredive jo-performuese ka zvogëluar dhënien e kredive dhe duhet të adresohet me veprime të mëtutjeshme të politikave. Papunësia mbetet e lartë në 28%.

Ekonomia është mesatarisht e përgatitur që të përballet me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit. Ka pasur pak progres në ndryshimin e strukturës së eksportit si rezultat i investimit direkt; lidhje tregtare dhe të investimeve janë forcuar edhe më tutje me BE-në. Mirëpo, vendi ka nevojë për përmirësoj punësimin e njerëzve, në veçanti të rinisë, duke bashkërenduar më mirë arsimimin me nevojat e tregut të punës, ngritjen e lidhjes në mes të investitorëve të huaj direkt dhe ekonomisë së vendit, dhe prioritizimin më të mirë të investimeve.

Për sa i përket **zotësisë për të marrë obligimet e anëtarësisë**, vendi ka një nivel relativisht të mirë të bashkërendimit me *acquis*. Një përqendrim më i madh është i nevojshëm në kapacitetin administrativ dhe zbatim efektiv. Në shumicën e fushave, vendi është mesatarisht i përgatitur, duke përfshirë fushat e prokurimit publik, statistikave dhe kontrollin financiar. Përpjekje të mëtutjeshme janë të nevojshme në të gjitha fushat, veçanërisht në ato pak fusha ku vendi është në fazat e hershme të përgatitjes.

Lëvizja e përzier e migracionit është rritur në mënyrë dramatike, duke krijuar një ngarkesë të konsiderueshme në kornizën e vendit mbi azilin dhe migracionin. Autoritetet kanë ndërmarrë masa për të siguruar një kalim të sigurtë për nacionalitetet e vendeve të treta që kalojnë në territorin e saj dhe kanë siguruar strehim dhe furnizime humanitare, me mbështetje të BE-së dhe të tjerëve.

## Shqipëria

Për sa i përket **kritereve politike**, zgjedhjet lokale në qershor të vitit 2015 janë mbajtur pa incidente të mëdha. Shqetësimet rreth paanësisë dhe profesionalizmit të autoriteteve zgjedhore dhe politizimi i përgjithshëm i procesit zgjedhorë ende duhet të adresohet. Në dhjetor të vitit 2014, parlamenti miratoi rezolutën që përcakton bazën që shumica udhëheqëse dhe partia kryesore opozitare të angazhohen në një dialog politik konstruktiv dhe të vazhdueshëm. Kjo i dha fund bojkotit gjashtë mujor të partisë kryesore opozitare. Mirëpo, duhet të bëhet edhe më shumë për të adresuar kulturën politike ndarëse dhe të sigurohet një dialog më konstruktiv ndër-partiak.

Për sa i përket reformës së administratës publike, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur. Strategjitë gjithëpërfshirëse të reformave dhe Kodi i ri i Procedurave Administrative janë miratuar. Mirëpo, përpjekjet janë të nevojshme për të arritur objektivin e një administrate publike profesionale dhe të de-politizuar, për të rritur kapacitetin financiar dhe administrativ të njësisve të qeverisjes lokale dhe të sigurojnë një zbatim efektiv të ligjit për shërbimin civil në nivel lokal.

Sistemi gjyqësor i Shqipërisë është në një fazë të hershme të përgatitjes. Të meta domethënëse ende mbesin në sistemin gjyqësor në lidhje me pavarësinë dhe llogaridhënien e gjyqtarëve dhe prokurorëve, zbatimin e vendimeve, bashkëpunimin ndër-institucional, dhe administrimin e drejtësisë që mbetet e ngadalshme. Një komision parlamentar është themeluar për të kryer një reformë gjithëpërfshirëse dhe gjithëpërfshirëse në drejtësi. Hapat e ardhshëm kritik janë miratimi i strategjisë për reformë në gjyqësor dhe planet vepruese të pasuara nga miratimi i masave të nevojshme institucionale, legjislative dhe procedurale.

Shqipëria ka arritur pak përgatitje në fushën e luftimit të korrupsionit. Strategjia e re dhe plani i veprimit anti-korrupsion janë miratuar. Mirëpo, korrupsioni është i përhapur gjithandej dhe përpjekje të mëtutjeshme janë në nevojshme për të pasur progres nga pikëpamja e themelimit të të dhënave të forta gjurmuese të hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve në të gjitha nivelet. Hetime proaktive, vlerësime sistematike të riskut dhe bashkëpunimi ndër-institucional duhet të përmirësohen. Pavarësia e institucioneve të përfshira në luftimin e korrupsionit duhet të rritet, pasi që ato mbesin të cenueshme nga presioni politik apo ndikime tjera të paligjshme. Vendi ka përgatitur pak përgatitje në lidhje me luftimin e krimit të organizuar. Shqipëria ka kryer një numër të operacioneve të zbatimit të ligjit që kanë qar në shkatërrimin e kultivimeve të mëdha të kanabisit. Mirëpo, numri i dënimeve përfundimtare efektive që qojnë në zhbërjen e organizatave kriminale mbetet i papërfillshëm në krahasim me vlerën e llogaritur të tregut kriminal rajonal dhe vendor. Hetimet financiare, masat kundër shpëlarjes së parave dhe konfiskimi i aseteve mbesin të nën-përdorura. Shqipëria duhet të themeloj të dhëna të gjurmueshme të hetimeve proaktive, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare në rastet e krimit të organizuar, duke përfshirë shpëlarjen e parave, dhe zhbërjen efektive të rrjeteve kriminale.

Korniza ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut gjerësisht është e përafuar me standardet Evropiane. Mirëpo, zbatimi efektiv i legjislacionit dhe strategjive relevante është i kufizuar dhe fuqizimi i mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut mbeten të pamjaftueshme. Për sa i përket lirisë së shprehjes, Shqipëria ka arritur pak përgatitje. Ambienti i përgjithshëm është në përgjithësi i favorshëm për lirinë e shprehjes, por zbatimi më i mirë i legjislacionit është i nevojshëm. Pavarësia e autoritetit rregullator dhe të transmetuesit publik duhet të forcohet më tepër. Fuqizimi i të drejtave pronësore mbetet të sigurohet, dhe procesi i regjistrimit të pronës, kthimit dhe kompensimit nuk janë përfunduar. Romët dhe Egjiptianët ballafaqohen me kushte shumë të vështira të jetesës dhe përjashtim social dhe diskriminim të shpeshtë. Në fushën e anti-diskriminimit, e drejta sipas praktikës së mëparshme duhet të zhvillohet më tutje. Mekanizmat institucional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve mbesin të dobëta. Sistemi i drejtësisë për të rinj dështoi të përmbushë standardet ndërkombëtare.

Shqipëria ka vazhduar që të marrë pjesë në mënyrë aktive në bashkëpunime rajonale dhe të mbajë marrëdhënie të mira fqinjësore në përputhëni me zotimet e saj sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Për sa i përket **kritereve ekonomike**, Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për zhvillimin e një ekonomie funksionale të tregut. Ka pasur pak progres në përmirësimin e stabilitetit makroekonomik dhe prospektet e rritjes janë përmirësuar. Inflacioni ka mbetur i ultë. Mirëpo, mbesin mjaft sfida domethënëse. Përpjekje të mëtutjeshme janë të nevojshme për të mbajtur konsolidimin fiskal, përmirësimin e ambientit biznesor dhe luftimin e ekonomisë joformale. Shqipëria gjithashtu duhet të përmirësojë kornizën për menaxhimin e buxhetit dhe të adresojë nivelin e lartë të kredive jo-performuese. Nivelet e papunësisë (17.5%) dhe punësimi joformal mbesin të larta.

Në lidhje me kapacitetin për tu përballë me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda

Unionit, Shqipëria është pak e përgatitur. Pak progres ka pasur në lidhje me infrastrukturën arsimore, të transportit dhe energjisë. Mirëpo, investime të mëdha në kapitalin njerëzor dhe fizik janë të nevojshme për të përmirësuar konkurrueshmërinë e Shqipërisë. Shqipëria duhet të përmirësojë cilësinë e arsimit të lartë dhe të vazhdojë me ristrukturimin e shkollave profesionale dhe të trajnimeve, të miratojë dhe zbatojë strategjitë kombëtare të transportit dhe energjisë dhe të zvogëlojë barrierat jo-tarifore në tregti siç janë të metat në siguri të ushqimit.

Shqipëria ka vazhduar të bashkërendoj legjislationin e saj me kërkesat e BE-së në një numër fushash, duke fuqizuar **zotësinë e saj për të marrë obligimet e anëtarësimit**. Në shumë fusha, vendi është mesatarisht i përgatitur, si në kontroll financiar, apo ka pak përgatitje, duke përfshirë fushat e prokurimit publik dhe statistikave. Mirëpo, Shqipëria ka nevojë për bëjë përpjekje substanciale për të ngritur përgatitjes e saj për zbatimin e *acquis*. Duhet të vazhdojë të punojë në zhvillimin e rrjetit të transportit dhe energjisë. Kapaciteti administrativ dhe standardet profesionale të organeve që janë përgjegjëse për zbatimin e *acquis* duhet të fuqizohen dhe të ruhet pavarësia e organeve të pavarura rregullatorë. Rritja e transparencës dhe llogaridhënies, veçanërisht duke siguruar funksionimin efektiv, efikas dhe transparent të sistemit të prokurimit publik dhe menaxhimit të financave publike, mbeten esenciale.

Autoritet Shqiptare pritjet që të vazhdojnë përpjekjet për të ndaluar numrin në rritje të aplikacioneve të pabazuara për azil të depozituara nga shtetasit e saj në Vendet Anëtare të BE-së dhe vendet që lidhen me Schengenin. Të gjitha aktivitetet për të kundërshtuar këtë fenomen negativ duhet të intensifikohen përmes mekanizmit monitorues së pas liberalizimit të vizave, veçanërisht pas rritjes së fundit gjatë verës.

## **Bosnja dhe Hercegovina**

Për sa i përket **kritereve politike**, në tetor të vitit 2014 zgjedhjet e përgjithshme janë administruar në mënyrë efikase dhe janë mbajtur në mënyrë të rregullt dhe në një ambient konkurrues. Asambleja Parlamentare e Bosnje Hercegovinës ka filluar të funksionoj dhe të punoj në agjendën legjislative. Agjenda e Reformave e miratuar, e cila cakton reforma të mesha socio-ekonomike që duhet të bëhen, është pasuar nga një progres fillestar në zbatim. Bashkëpunimi në mes të Nivelit-Shtetëror, Nivelit të Entiteteve dhe Krahinës Brčkoende duhet të përmirësohet. Bashkëpunimi më i ngushtë dhe koordinimi në mes të të gjitha niveleve të qeverisë duhet të themelohet, jo së paku vetë për të qenë të gjendje që të merren me sfidat e mëdha socio-ekonomike.

Kushtetuta e vendit ka themeluar një arkitekture komplekse institucionale që mbetet jo-efikase dhe është subjekt i interpretimeve të ndryshme. Kushtetuta mbetet shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, siç është cekur në vendimin *Sejdić-Fincić* të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe duhet të amendamentohet.

Vendi është në një fazë të hershme të reformës së administratës publike, me një nivel të lartë politizimi dhe sigurim të dobët të shërbimeve. Themelimi i një kornize të re strategjike që siguron udhëzime të duhura politike për reformën e administratës publike në vend është e nevojshme.

Sistemi gjyqësor i Bosnje Hercegovinës ka arritur pak përgatitje. Strategjia Sektoriale e Reformës së Gjyqësorit është miratuar dhe tani duhet të zbatohet. Në shtator në takimin ministror në kornizën e Dialogut të Strukturuar, autoritetet përsëritën zotimin e tyre për zhvillimin e përbashkët të tipareve kyçe të reformës së gjyqësorit.

Bosnja dhe Hercegovina ka pak përgatitje në luftimin e korrupsionit. Strategjia dhe plani ve-

prues anti-korrupsion që mbulon vitet 2015-2019 është miratuar. Ka pasur një rritje substanciale në konfiskimin e aseteve. Korrupsioni vazhdon të mbetet i shtrirë gjithandej dhe zotimi politik në këtë çështje nuk është përkthyer në rezultate konkrete. Korniza ligjore dhe institucionale mbetet e dobët dhe jo-adekuate. Mungesa e fuqizimit të ligjit ndikon keq në qytetare dhe institucione. Ndëshkimet që janë në fuqi nuk përbëjnë një sigures të mjaftueshëm kundër korrupsionit.

Në lidhje me luftimin e krimit të organizuar, vendi ka arritur pak përgatitje. Përderisa ka pasur një numër të operacioneve të përbashkëta të një shkalle të lartë në vitet e kaluara, disa që përfshinin vendet fqinjë, koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të institucioneve në tërë vendin duhet të përmirësohen mjaft shumë. Numri i dënimeve finale mbetet i ultë. Hetimet financiare mbesin të nën-përdorura. Mungesa e koordinimit strategjik po e frenon punën efektive të shërbimeve policore.

Bosnja dhe Hercegovina ballafaqohet me shumë sfida në lidhje me të drejtat e njeriut dhe mbrojtjen e minoriteteve. Korniza ligjore dhe institucionale për respektimin e të drejtave të njeriut kërkon përmirësime substanciale dhe legjislacioni i miratuar duhet të zbatohet në mënyrë efektive, veçanërisht në lidhje me aspektet anti-diskriminuese. Kushtet për ushtrimin e lirisë së shprehjes janë prishur gjatë periudhës raportuese. Ndonëse ka pak përgatitje në këtë dhe dispozitat ligjore janë si duhet, ambienti institucional dhe politik nuk është i drejtuar në krijimin e kushteve për lirinë e plotë të shprehjes. Komuniteti i lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve, transeksualëve dhe interseksualëve kanë vazhduar të jenë subjekt i kërcënimeve dhe sulmeve. Janë ndërmarrë disa hapa në regjistrimin dhe strehimin e minoritetit Romë, por ka pasur vepërime të kufizuara sa i përket shëndetit, arsimit dhe punësimit.

Vendi ka vazhduar të jetë pjesëmarrës aktiv në iniciativa rajonale dhe ka pasur progres në marrëdhënie të mira fqinjësore, duke përfshirë nënshkrimin e marrëveshjes të kufirit me Malin e Zi në gusht. Në maj, Bosnja dhe Hercegovina ka marrë kryesimin e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

Në lidhje me **kriteret ekonomike**, Bosnja dhe Hercegovina është në fazën e hershme të zhvillimit të një ekonomie funksionale të tregut. Pak progres është bërë në përmirësimin e ambientit të biznesit, veçanërisht në lehtësinë e hyrjes në treg dhe lëshimin e lejeve të ndërtimit. Pavarësisht nga pengesat e përmbytjeve të vitit 2014, rritja ekonomike e morri veten shpejt. Mirëpo, kushtet e vështira të punës kanë mbetur në masë të madhe të pandryshuara, me një papunësi prej 27.6%, që shkon në 62.7% në mesin e të rinjve. Në mënyrë që merret me papunësinë e lartë dhe raportin e ultë të pjesëmarrjes, vendi duhet të zvogëlojë ngurtësinë e tregut të punës, duke përfshirë zvogëlimin e raportit midis çmimit/sasisë si rezultat i tatimit (“tax wedge”). Cilësia dhe qëndrueshmëria e financave publike është prishur. Ambienti biznesor ka mbetur i dobët, duke penguar një rikthim më të fortë të ekonomisë. Qeveria duhet të përmirësoj cilësinë e qeverisjes së sektorit publik, ne veçanti duke rritur hapësirën fiskale për rritje duke rritur investimin kapital. Veç kësaj, hapa konkret janë të nevojshëm për të përmirësuar kornizën e menaxhimit të buxhetit, për të avancuar privatizimin dhe për të përmirësuar ambientin biznesor.

Bosnja dhe Hercegovina është në një fazë të hershme për të arritur kapacitetin për tu përballë me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit. Pak progres është arritur në liberalizimin e tregut të energjisë. Mirëpo, për të rritur konkurrueshmërinë e vendit, autoritetet duhet ti kushtojnë vëmendje të veçantë zhvillimit më strategjik të qasjes ndaj mungesave në sistemin arsimor dhe të trajnimeve; thjeshtësimi i procedurave komplekse për eksport dhe zhvillimi i stërgjisë së transportit dhe një strategjie të energjisë.

Bosnja dhe Hercegovina është në një fazë të hershme në lidhje me përafrimin me **standardet**

**Evropiane.** Ka pak përgatitje në lidhje me prokurimin publik dhe tregun e brendshëm. Vendi është në një fazë të hershme në fushën e transportit, por miratimi i Politikës së Transportit në korrik është një hap pozitiv drejt përfitimit të vendit nga agjenda e lidhjes. Mirëpo, përpjekje mjaft të mesha janë të nevojshme në shumicën e fushave të politikave për vendin në mënyrë që tutje të bashkërendohet me *acquist* të BE-së. Kjo përfshinë kontrollin financiar si dhe statistikat ku vendi është në një fazë të hershme dhe hapa madhor janë të nevojshëm për të adresuar prioritetet e shquara. Në lidhje me këtë, përpunimi i të dhënave nga regjistrimi i popullsisë së vitit 2013 dhe publikimi i rezultateve duhet të përfundojë. Përpjekje të mëtutjeshme të qëndrueshme janë gjithashtu të nevojshme në veçanti në lidhje me gjyqësinë, lirinë dhe çështjet e sigurisë, fushën e konkurrencës, industri dhe NVM, bujqësi, politika të ambientit dhe ndryshimeve klimatike, energji, shoqëri informatike dhe media.

## **Kosova**

Për sa i përket **kritereve politike**, rruga qorre politike gjashtë mujore pas zgjedhjeve në qershor 2014 i ka vonuar reformat kyçe. Kjo përfundoi në dhjetor, kur Partia Demokratike e Kosovës (PDK) formoi koalicionin me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe partitë e minoriteteve. Në gusht, Kuvendi i Kosovës votoi në favor të amendamenteve kushtetuese për themelimin e Dhomave të Veçanta dhe Zyrës së Prokurorisë Speciale, do cilat do të ndjekin penalisht rastet e krimeve përtej kufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë. Qeveria gjithashtu ka arritur marrëveshje kyçe me Beogradin në gusht. Të dy vendimet kanë kërkuar zotim të fortë politik nga ana e qeverisë.

Ka pasur polarizim në rritje në mes të qeverisë dhe opozitës. Anëtarë të opozitës kanë qenë të përfshirë në incidente të dhunshme ndaj qeverisë, duke e kritikuar atë për vendimin për Dhoma të Specializuara, marrëveshjet e dialogut me Beogradin, dhe marrëveshjen e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi.

Shumë institucione të pavarura dhe autoritete rregullatore aktualisht nuk janë operacionale apo janë të ndikuara negativisht nga emërimet e vonuara të anëtarëve të bordit. Si qeveria ashtu edhe Parlamenti urgjentisht duhet të përzgjedhin anëtarët e bordeve për këto institucione dhe të përcaktojnë mekanizmat për llogaridhënien e tyre. Emërimet duhet të bëhen në bazë të kualifikimeve profesionale dhe meritave, e jo patronazhit politik. Zgjedhja e kohëve të fundit e Avokatit të Popullit ka qenë një zhvillim pozitiv në këtë drejtim.

Qeveria ka rritur fokusin në reformën në administratën publike, që ka arritur një nivel të caktuar të përgatitjes. Progres i mirë është bërë në avancimin e kornizës strategjike dhe ligjore. Politizimi i vazhdueshëm i administratës publike, megjithatë, është një shqetësim i madh. Llogaridhënia duhet të përmirësohet në tërë administratën përmes mbikëqyrjes së duhur. Çdo dyfishim i përgjegjësive të agjencive qeveritare duhet të shmanget. Mbikëqyrja parlamentare për zbatimin e buxhetit duhet të bëhet më e besueshme dhe transparente. Menaxhimi i shëndoshë financiar duhet të sigurohet për të gjitha institucionet publike.

Sistemi gjyqësor i Kosovës është në fazën e hershme të përgatitjes. Një pako amendamentesh të kate ligjeve thelbësore është miratuar, ku janë ndërmarrë hapa në drejtim të modernizimit të sistemit gjyqësor. Mirëpo, gjyqësori mbetet i prirë ndaj ndërhyrjes politike. Përpjekje shtesë kërkohen për të siguruar pavarësinë në ligj dhe praktikë, për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin brenda gjyqësorit, për të rekrutuar dhe trajnuar më shumë staf të kualifikuar dhe të ndahen resurse adekuate.

Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes në luftimin e korrupsionit. Një qasje

gjithëpërfshirëse dhe strategjike është e nevojshme që të sigurohen rezultate reale në luftimin e korrupsionit endemik në Kosovë. Regjistri i ndjekjeve penale dhe dënimeve të suksesshme mbetet të themelohen. Hetimet e rralla në korrupsionet e nivelit të lartë nuk kanë rezultuar për një kohë të gjatë me dënime finale.

Kosova është në një fazë të hershme të përgatitjes në luftimin e krimit të organizuar. Pak progres është bërë në bashkëpunimin ndër-institucional dhe shkëmbimin e informatave mbi hetimet ndërmjet agjencive për zbatimin e ligjit. Mirëpo, numri i hetimeve dhe dënimeve përfundimtare mbetet i ultë. Konfiskimi i aseteve rrallë aplikohet. Fokusi në strategji dhe plane veprimi nuk duhet të paqartësojë nevojën për rezultate reale në luftimin e krimit të organizuar endemik në Kosovë. Kosova nga ngritur përpjekjet në luftimin e terrorizmit, por vazhdon të ballafaqohet me sfida që lidhen me radikalizmin.

Miratimi i pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut e ka forcuar strukturën institucionale dhe ka sqaruar rolet e institucioneve të ndryshme. Ka nevojë për ngritje të vëmendjes politike, megjithatë, për të siguruar zbatimin e duhur dhe adresimin e mungesës së resurseve. Në fushën e lirisë së shprehjes, Kosova ka një nivel të caktuar të përgatitjes. Korniza legjislative dhe institucionale mbetet e ndarë dhe pjesërisht jo-efektive. Transmetuesi publik është i cenueshëm nga presioni politik dhe mungesa e financimit të qëndrueshëm. Dhuna ndaj grave dhe qasja e kufizuar e grave në pronësi pengojnë ushtrimin e plotë të të drejtave të tyre. Mbrojtja e personave me të meta dhe personave që i takojnë minoriteteve, në veçanti komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian, duhet të forcohen në mënyrë të dukshme.

Lidhur me **normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë**, Kosova ka mbetur e zotuar në zbatimin e 'Marrëveshjes së parë të parimeve qeverisëse të normalizimit të marrëdhënieve' të prillit 2013 dhe marrëveshjeve tjera të arritura në dialogun e ndihmuar nga BE-ja. Marrëveshjet kyçe janë finalizuar në gusht mbi energjinë, telekomin, themelimin e Asociacionit/Komunitetit të komunave me shumicë Serbe si dhe Urën e Mitrovicës. Dialogu gjithashtu ka arritur edhe rezultate të mëtutjeshme konkrete në fushat e drejtësisë, integritit të mbrojtjes civile, sigurimit të makinave, të hyrave doganore dhe MIK. Gjithashtu ka pasur edhe diskutime konstruktive në përmirësimin e bashkëpunimit në ndalimin e rrjedhave të migrimit nga Kosova. Hapat e ndërmarrë i kanë dhënë një momentum të freskues normalizimit të marrëdhënieve dhe duhet të kenë ndikim pozitiv dhe konkret në jetën e përditshme të qytetarëve në Serbi dhe Kosovë.

Për sa i përket **kritereve ekonomike**, Kosova është në një fazë të hershme të zhvillimit të një ekonomie funksionale të tregut. Deficiti i vazhdueshëm tregtar reflekton bazën e ultë të prodhimit dhe mungesë të konkurrencës ndërkombëtare. Mbështetja në remitenca dhe ekonomia joformale e përhapur gjithandej ulë shtytësit e punësimit që kontribuon në pjesëmarrjen veç të ultë të tregut të punës dhe papunësinë e lartë, e cila qëndron në 35.3%, e ngritet në 61% në mesin e të rinjve. Administrata publike jo-efikase dhe një qasja ad hoc në politikën fiskale përbën një rrezik mjaft të madh fiskal. Kosova duhet të forcojë kornizën fiskale afatmesme, përmirësoj transparencën e financave publike dhe të zhvendosë shpenzimet buxhetore në drejtim të rritjes. Kosova gjithashtu duhet të përshpejtojë privatizimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve publike dhe të përmirësoj procedurat e falimentimit dhe paafësisë paguese, si dhe të zvogëloj mbështetjen në taksat doganore duke zgjeruar bazën tatimore vendore dhe modernizimin e mbledhjes së të hyrave.

Kosova është në një fazë të hershme të arritjes së kapaciteteve për tu përballë me presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Unionit. Forma madhore ende janë të nevojshme për të siguruar furnizim të qëndrueshëm me energji dhe zvogëlimin e humbjeve në distribucion, të mbyllet boshllëku i aftësinë në treg të punës, dhe kanalizimi i investimeve të huaja direkte dhe remitenca në sektorët prodhues.

Kosova është në një fazë të hershme të bashkërendimit me **standardet Evropiane**, duke përfshirë fushat e prokurimit publik, statistikave dhe kontrollit financiar. Bashkërendimi legjislativ në disa fusha është i lartë por zbatimi është i dobët. Pak progres është bërë në fushën e prokurimit publik, veçanërisht në fuqizimin e sistemit të centralizuar të prokurimit publik, por shqetësimet rreth korrupsionit vazhdojnë. Sa i përket kontrollit financiar, është bërë pak progres, veçanërisht në auditim të jashtëm. Mirëpo, përpjekje të dukshme janë të nevojshme për zbatimin e kontrollit të brendshëm financiar publik në tërë administratën dhe ndërmarrjet shtetërore.

## **Turqia**

Sa i përket **kritereve politike**, ecuria e reformave është ngadalësuar edhe për shkak të zgjedhjeve të zgjatura. Qeveria në largim bënte përpjekje për të rforcuar procesin e pranimit në BE. Por, ky përkushtim i përsëritur vihet në pikëpyetje pas miratimit të ligjeve kryesore në fushën e sundimit të ligjit, lirisë së shprehjes dhe lirisë së tubimit, të cilat bien ndesh me standardet evropiane. Situata politike vazhdon të jetë e ndarë.

Zgjedhjet e përgjithshme të 7 qershorit kanë shënuar pjesëmarrjen e 84% të votuesve, gjë që paraqet një shenjë të qartë të fuqisë së demokracisë turke, ku të gjitha partitë e mëdha politike përfaqësohen në parlamentin e ri. Megjithatë, Qeveria nuk ka mundur të formohet brenda afatit kushtetues, kështu që më 1 nëntor u përsëritën zgjedhjet. Në mesin e mangësive të kornizës ligjore që i rregullon zgjedhjet është ai i caktimit të pragut prej 10% për përfaqësimin e partive në parlament, gjë që duhet të adresohet si çështje prioritare.

Në periudhën e raportimit, Turqia pati një situatë sigurie gjithnjë e më të brishtë. Autoritetet filluan një fushatë ushtarake dhe të sigurisë kundër pjesëtarëve të Partisë Punëtore Kurde (PKK), e cila mbetet në listën e BE-së të organizatave terroriste, si në Turqi ashtu edhe në Irak. Procesi i rregullimit të çështjes së kurdëve është ndërprerë përkundër zhvillimeve pozitive të mëhershme mbi këtë çështje.

Më 10 tetor, Turqia u godit nga sulmi terrorist më vdekjeprurës në historinë e saj moderne, i cili mori jetët e demonstruesve që ishin mbledhur për një protestë paqësore, e cila ishte organizuar nga sindikatat dhe forumet e të rinjve të partive politike opozitare. Është qenësore të bëhen hetime të shpejta dhe transparente lidhur me këto akte rrëqethëse që kishin për qëllim destabilizimin dhe dëmtimin e demokracisë së Turqisë.

Turqia është mesatarisht e përgatitur për reformën e administratës publike. Ajo ka një shërbim të fuqishëm publik dhe është e zotuar për një administratë të orientuar kah përdoruesit. Megjithatë, impulsi për një reformë më gjithëpërfshirëse është i dobët. Largimet nga puna dhe uljet në detyrë që kanë ndodhur së fundi me arsyetim të luftimit të “strukturës paralele” kanë qenë një shqetësim.

Shoqëria civile ka mbetur aktive, duke u rritur numerikisht dhe duke vazhduar të përfshihet në shumë sfera të jetës publike, por kufizimet e lirisë së tubimit mbeten një shqetësim serioz.

Sistemi gjyqësor i Turqisë ka nivel të ulët përgatitjeje. Pavarësia e gjyqësorit dhe parimi i ndarjes së pushteteve janë dobësuar, kurse gjykatësit e prokurorët kanë qenë nën presion të fuqishëm politik. Fushata e qeverisë ndaj “strukturës paralele” të supozuar në kuadër të shtetit është ndjekur në mënyrë aktive, nganjëherë edhe duke kaluar kufijtë e pavarësisë së gjyqësorit. Përpjekje të mëdha duhet të bëhen në kthimin dhe sigurimin e pavarësisë së tyre.

Sa i përket luftimit të korrupsionit, Turqia ka bërë pak përparim në parandalimin dhe luftimin efektiv të korrupsionit. Regjistrimi i rasteve të luftimit të korrupsionit në Turqi mbetet i pam-

jaftueshëm. Korrupsioni është shtrirë gjithandej. Ndikimi i paligjshëm i ekzekutivit në hetimin dhe ndjekjen e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë vazhdon të jetë një shqetësim i madh.

Turqia ka arritur pak nivel përgatitjeje në luftimin e krimit të organizuar. Hetimet financiare mbeten të nën-realizuara. Ngrirja parandaluese e pasurive aplikohet rrallë dhe numri i pasurive të konfiskuara mbetet i ulët. Mungesa e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave është një pengesë për një bashkëpunim më të gjerë të Turqisë me agjenci të BE-së dhe me shtetet anëtare.

Kushtetuta e Turqisë garanton mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Implementimi është përmirësuar dukshëm gjatë viteve të kaluara. Megjithatë, mbeten mangësi të mëdha. Fuqizimi i të drejtave që burojnë nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) dhe nga ligji për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut (ECtHR) nuk është siguruar plotësisht. Shtrohet nevojë urgjente miratimi i një kornize ligjore gjithëpërfshirëse për luftimin e diskriminimit, në pajtim me standardet evropiane. Turqia, po ashtu, duhet të garantojë në mënyrë efektive të drejtat e grave, fëmijëve, dhe individëve të komunitetit të lezbikeve, homoseksualëve, biseksualëve dhe transgjnorëve e interseksualëve (LGBTI) dhe duhet t'i kushtojë vëmendje të mjaftueshme përfshirjes sociale të grupeve të cënueshme, si komuniteti rom.

Ka pasur shkelje të konsiderueshme në fushën e lirisë së shprehjes dhe të lirisë së tubimit. Legjislacioni për siguri të brendshme kundërshton masat e përcaktuara në planin e veprimit të marsit 2014 për parandalimin e shkeljeve të ECHR, përmes dhënies së lirisë së gjerë të veprimit agjencive për sundimin e ligjit, pa sigurimin e mbikëqyrjes të duhur. Pas disa vitesh përparimi në lirinë e shprehjes, gjatë dy viteve të kaluara kanë ndodhur shkelje të mëdha, dhe ka pasur pak nivel të përgatitjes në këtë fushë. Ndonëse ka qenë e mundur të diskutohen disa çështje të ndjeshme dhe diskutueshme në një mjedis të lirë, rastet e reja dhe të vazhdueshme të ndjekjes penale të gazetarëve, shkrimtarëve ose përdoruesve të rrjeteve sociale përbëjnë shqetësim të madh. Ndryshimet në ligjin për internetin, të cilat paraqesin një devijim të madh nga standardet evropiane, e kanë rritur pushtetin e qeverisë për të bllokuar përmbajtjen padrejtësisht, pa urdhër gjykatë, mbi baza të caktuara.

Turqia, në muajin maj, e ka mbështetur rifillimin e bisedimeve për rregullimin e çështjes së Qipros dhe ka deklaruar mbështetjen e saj për përpjekjet e Këshilltarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara (SP i OKB). Angazhimi i vazhdueshëm i Turqisë dhe kontributi i saj konkret është qenësor për një zgjidhje gjithëpërfshirëse. Megjithatë, Turqia nuk e ka përmbushur ende obligimin e saj për të siguruar implementimin e plotë dhe jodiskriminues të Protokollit Shtesë për Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe nuk i ka hequr të gjitha pengesat për lëvizjen e lirë të mallrave, përfshirë kufizimet në transportin e drejtpërdrejtë me Qipron. Po ashtu, nuk ka pasur progres në normalizimin e marrëdhënieve bilaterale me Republikën e Qipros. Konkluzionet për Turqinë, të miratuara nga Këshilli (për Punë të Përgjithshme dhe Marrëdhënie të Jashtme), më 11 dhjetor 2006, dhe nënshkrimi i Këshillit Evropian më 14/15 dhjetor 2006, mbeten në fuqi. Ato theksojnë që negociatat nuk do të hapen për tetë kapitujt<sup>5</sup> që kanë të bëjnë me kufizimet e Turqisë lidhur me Republikën e Qipros dhe asnjë kapitull nuk do të mbyllet derisa Komisioni të konfirmojë se Turqia e ka implementuar plotësisht Protokollin Shtesë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit.

Turqia duhet të angazhohet qartazi për marrëdhënie të mira fqinjësore dhe për zgjidhje paqësore të mosmarrëveshjeve në pajtim me Kartën e Kombeve të Bashkuara, duke kërkuar ndihmë nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, nëse është e nevojshme. Në këtë kontekst, BE-ja ka shprehur edhe një herë shqetësimin serioz dhe ka kërkuar nga Turqia që të shmangë çdo

---

<sup>5</sup> Lëvizja e lirë e mallrave, e drejta për themelim dhe liria për të ofruar shërbime, shërbime financiare, zhvillim bujqësor dhe rural, peshkatari, politikë të transportit, union doganor dhe marrëdhënie me jashtë.



Iloj kërcënimi ose veprimi kundër ndonjë shteti anëtar ose kundër ndonjë burimi mosmarrëveshesh apo veprimet që dëmtojnë marrëdhëniet e mira fqinjësore dhe zgjidhjen paqësore të mosmarrëveshjeve.

Lidhur me **kriteret ekonomike**, ekonomia turke është avancuar mirë dhe mund të konsidërohet një ekonomi funksionale e tregut me rritja ekonomike mesatare. Turqia ka vazhduar të ballafaqohet me debalans të qarkullimit të jashtëm dhe të brendshëm, duke bërë thirrje për përshtatje të politikave monetare dhe fiskale si edhe për një përshtetje të reformave strukturore gjithëpërfshirëse. Deficiti i madh buxhetor ka vazhduar të ndikojë në ndjeshmërinë e ekonomisë ndaj ndryshimeve të kushteve monetare dhe ecurive të tregut. Në planin e brendshëm, shkalla e inflacionit ka vazhduar të jetë relativisht e lartë, gjë që është problematike për stabilitetin makro-ekonomik, alokimin e burimeve dhe ndikimet ri-shpërndarëse. Ajo e ka tejkaluar përsëri objektivin zyrtar; por Banka Qendrore i ka zvogëluar normat e interesit. Borxhi publik ka arritur një nivel të qëndrueshëm, mirëpo bilanci i përgjithshëm struktural i qeverisë ka qenë mjaft negativ. Papunësia është rritur pak dhe arrin një mesatare vjetore prej 9.9 %. Pak progres është shënuar në reformat strukturore, si në përmirësimin e normës së shkollimit dhe në liberalizimin e mëtejshëm të sektorit energjetik. Reformat e tilla duhet të përshtejtohen në mënyrë që të përmirësojnë funksionimin e tregjeve të mallrave, shërbimeve dhe punës.

Turqia ka një nivel të mirë përgatitjeje të kapacitetit për të përballuar presionin e konkurrencës dhe fuqinë e tregut të BE-së. Cilësia në arsim dhe barazia gjinore në arsim kanë nevojë për vëmendje të veçantë. Kërkohen përpjekje për të siguruar transparencën e ndihmës së shtetit dhe për të hequr pengesat dhe përjashtimet në fushën e prokurimit publik.

Lidhur me **mundësinë për të marrë obligimet e anëtarësimit**, Turqia ka vazhduar të përfrohet me *acquis*, ndonëse me një ritëm më të ngadalshëm, dhe ka arritur një nivel të mirë përgatitjeje në shumë fusha. Turqia ka avancuar mirë në fushën e ligjit për kompanitë, shërbimet financiare, rrjetet ndërvropiane, shkencën dhe hulumtimet. Vendi ka arritur gjithashtu një nivel të mirë përgatitjeje në fushën e lëvizjes së lirë të mallrave, ligjit për pronën intelektuale, politikën ndërmarrëse dhe industriale, bashkimin doganor dhe marrëdhëniet me jashtë. Turqia mbetet e mobilizuar shumë për të adresuar sfidat e jashtëzakonshme të migrimit dhe azilit. Turqia ka arritur një nivel të mirë të përgatitjes në fushën e kontrollit financiar. Megjithatë, duhen përpjekje të konsiderueshme për implementimin e kontrollit financiar të brendshëm e publik, në të gjitha nivelet. Turqia është vetëm mesatarisht e përgatitur për prokurimin publik, meqë boshllëqe të rëndësishme mbeten në përafrimin e saj.

Turqia, po ashtu, është mesatarisht e përgatitur në fushën e statistikave, ku nevojiten përpjekje të mëdha gjithandej. Në të gjitha fushat, kërkohet më shumë vëmendje në fuqizimin e legjislacionit derisa shumë fusha kërkojnë progres të mëtejshëm, të konsiderueshëm, në arritjen e përafrimit legjislativ me *acquis* të BE-së.

Ngjarjet në Siri dhe në Irak bënë që vitin e kaluar Turqia të ballafaqohet me rritje të mëtejshme të numrit të **refugjatëve dhe personave të zhvendosur**. Turqia aktualisht e strehon pjesën më të madhe të refugjatëve në botë, rreth 2 milionë e të cilëve janë sirianë. Menaxhimi i një fluksi kaq të madh të refugjatëve dhe të personave të zhvendosur është një sfidë e madhe për Turqinë, e cila tashmë i ka shpenzuar mbi 6.7 miliardë euro për këtë qëllim.

## SHTOJCA 2 - NDRYSHIMET NË RAPORTET VJETORE TË VENDEVE

### I NDRYSHIMET KRYESORE

Komisioni, në raportet e këtij viti për vendet në zgjerim ka bërë një numër të ndryshimeve në krahasim me vitet e kaluara. Qëllimi i tyre është të rritja e mëtejshme e cilësisë së vlerësimeve të raporteve dhe besueshmëria e pakos si burim informacioni për të gjitha palët e interesit. Mënyra e re e raportimit ofron transparencë më të madhe në procesin e zgjerimit. Kjo duhet të lehtësojë një shqyrtim më të hollësishëm nga të gjitha palët e interesit. Pakoja gjithashtu duhet të shfrytëzohet për të matur më mirë rezultatet e politikave tona dhe asistencës financiare, përfshirë mundësimin e monitorimit të performancës së IPA II. Rrjedhimisht, raportet:

- e rrisin fokusin në gjendjen e tanishme për të treguar më qartë se ku qëndrojnë vendet përsa i përket përgatitjeve të tyre për të përmbushur kriteret e anëtarësimit. Kjo gjithashtu do të duhej t'ia mundësonte lexuesit që ta vendoste progresin që po bëhet në një kontekst më të qartë;
- ofrojnë më shumë udhëzime për atë se në çka duhet të fokusohen vendet gjatë vitit vijues, gjë që do të mundësonte që raportimi i radhës për progresin të jetë më relevant dhe më i fokusuar në çështjet kyçe dhe në pritjet nga secili vend;
- përfshijnë norma më të harmonizuara të raportimit dhe vlerësimit, të cilat do t'u mundësojnë vendeve që të krahasohen drejtpërsëdrejti në fushat kyçe. Ne presim që krahasueshmëria e drejtpërdrejtë do të mund të ofrojë një stimulim për intensifikimin e reformave.

#### **Fokusi te çështjet fundamentale**

Ndryshimet në raportet vjetore marrin parasysh nevojën për renditjen e përshtatshme të reformave. Në vitin 2015 është duke u aplikuar prezantimi i ri, si një qasje pilot që fokusohet në prioritetet politike aktuale dhe në dobësitë e vendeve në zgjerim. Rrjedhimisht, prezantimi i ri aplikohet në këto fusha:

- Sundimi i ligjit dhe të drejtat themelore (funksionimi i gjyqësorit, korrupsioni, krimi i organizuar, liria e shprehjes)
- Kriteret ekonomike
- Reforma e administratës publike
- Tre kapitujt që janë të lidhur ngushtë me ata më lart (prokurimin publik, statistikat, kontrollin financiar)

Këto “çështje fundamentale” gjithashtu janë fushat kryesore ku po punohet për standardizim më të mirë të reformave. Kjo ka të bëjë posaçërisht me mënyrën si trajtohet sundimi i ligjit në negociatat për anëtarësim dhe me zbatimin e qasjes së re për Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore dhe Kapitullin 24 - Drejtësia, liria dhe siguria. Kjo qasje u jep prioritet reformave në këto fusha, duke siguruar që ato të adresohen në fazën e hershme të procesit të

anëtarësimit. Kjo u lejon vendeve në zgjerim kohë maksimale që para anëtarësimit të krijojnë regjistra të dhënash mbi rezultatet konkrete që sigurojnë qëndrueshmërinë e reformave.

Kjo vlen edhe për qeverisjen ekonomike, ku po zbatohen propozimet e vitit 2014 të Komisionit. Të gjitha vendet i kanë miratuar Programet për Reformë Ekonomike dhe këto u janë nënshtruar diskutimeve ministrore dhe procesit të miratimit të rekomandimeve të përbashkëta, në maj të vitit 2015. Gjithashtu, e një rëndësie të veçantë është edhe puna në reformën e administratës publike (RAP). Puna në këtë drejtim është intensifikuar me finalizimin e parimeve të RAP-it nga BE-ja dhe OZhBE-ja (SIGMA) në bazë të së cilave duhet të përmirësohet zbatimi i reformave të RAP-it.

Komisioni do të nxjerrë mësim nga qasja pilot që është aplikuar këtë vit dhe do të reflektojë në përshtatjet e mëtejme që mund të jenë të nevojshme. Gjithashtu do të shqyrtojë mundësinë për shtrirje të mëtejme të qasjes së rikalibruar në fushat tjera gjatë raportimeve të ardhshme. Kjo duhet të marrë parasysh nevojën për të siguruar renditje të përshtatshme të reformave/harmonizimit duke marrë parasysh kapacitetin e kufizuar administrativ të vendeve në zgjerim dhe nevojës së vazhdueshme të fokusimit të çështjet fundamentale. Për sa i përket ekonomisë, Komisioni do të shqyrtojë përpunimin e nën-kritereve dhe parametrave për anëtarësim të dy kritereve ekonomike të Kopenhagës<sup>6</sup>, duke marrë parasysh edhe sfidat dhe specifikat e vendeve aktuale në zgjerim, krahasuar me ato të zgjerimit të pestë, kur janë krijuar nën-kriteret ekonomike.

## **Normat e vlerësimit**

Në secilën prej fushave pilot, si gjendja aktuale ashtu edhe niveli i progresit, është vlerësuar sipas normës standarde të vlerësimit pesë shtresore.

Pesë termat e përdorura në raport për gjendjen e tanishme janë si në vijim:

<i>Fazë e hershme - Nivel i pakët i përgatitjes - I përgatitur në mënyrë mesatare - Nivel i mirë i përgatitjes - I avancuar mirë</i>
--

Pesë termat e përdorura në raport për vlerësimin e progresit gjatë 12 muajve të kaluar janë si në vijim:

<i>Kthim prapa – Nuk ka progres- Pak progres - Progres i mirë - Progres shumë i mirë</i>
--

Në raporte, ofrohet një vlerësim për gjendjen e tanishme, ndërsa një tjetër për progresin në secilën fushë pilot. Këto vlerësime bazohen në një analizë të kujdesshme të gjendjes sipas secilit nëntitull të secilës fushë që është pilot. Këta nëntituj janë shpjeguar më poshtë. Theks i veçantë i është dhënë rëndësisë së zbatimit dhe regjistrimit të të dhënave të rezultateve konkrete në secilën fushë. Rrjedhimisht, këtyre fushave u është dhënë më shumë peshë se sa harmonizimit ligjor dhe kornizës institucionale të vlerësimit të përgjithshëm.

<sup>6</sup> Këto kërkojnë ekzistimin e ekonomisë funksionale të tregut si dhe kapacitetit për tu ballafaquar me presionet e konkurrencës dhe forcave të tregut përbrenda Bashkimit.

## Përmirësimi i mbledhjes së informatave

Niveli i informatave që janë në dispozicion lidhur me ato vende që janë në fazën e hershme të procesit në përgjithësi është më i ulët se sa për ato që janë në fazë më të avancuar. Në mënyrë që të kuptohen sa më thellë sfidat e reformave në të gjitha vendet në zgjerim, Komisioni synon të rrisë nivelin e angazhimit dhe mbledhjes së informatave në të gjitha vendet. Kjo do të bëhet përmes shfrytëzimit më sistematik të mekanizmave ekzistuese, siç është TAIEX, për shembull përmes misioneve vetë-vlerësuese (të bashkëmoshatarëve) të shënjestruara më shpesh dhe më mirë, duke përfshirë ekspertët nga shtetet anëtare. Do të shfrytëzohen edhe forumet relevante për përmirësim të mbledhjes së informatave, përfshirë takimet në kuadër të MSA-së, dialogët e nivelit të lartë dhe konsultimet teknike.

## II FUSHAT PILOT

### ➤ FUNKSIONIMI I GJYQËSORIT

Vendet kanë nevojë të ndërmarrin reforma gjyqësore që kanë ndikim të gjerë, me qëllim të sigurimit të sistemeve gjyqësore të pavarura dhe efikase që do të jenë në gjendje të sigurojnë gjykime të drejta, ku gjykatësit dhe prokurorët emërohen dhe promovohen në bazë të meritës dhe ku ata janë të paanshëm e të përgjegjshëm dhe nuk i nënshtrohen presionit politik apo të ndonjë lloji tjetër. Strategjitë për reforma gjyqësore duhet të jenë të besueshme e të fuqishme dhe të zbatohen me efikasitet. Garantuesit kushtetues dhe ligjorë janë jetikë për të siguruar pavarësinë e plotë. Këshillat gjyqësore dhe prokuroriale duhet të jenë të pajisura në mënyrë që ta luajnë rolin e tyre të plotë si organe të menaxhimit, dhe të sigurojnë pavarësinë e tyre dhe llogaridhënien. Masat për të siguruar cilësinë dhe efikasitetin e drejtësisë përfshijnë adresimin e numrit të madh të lëndëve të prapambetura, procedurat e stërzgjatura dhe jurisprudencën jo konsistente, si edhe sigurimin se të gjitha vendimet e gjykatave zbatohen si duhet. Nevojitet ndryshim në kulturën gjyqësore drejt një fokusi në rritje për ofrimin e shërbimit për qytetarët.

Gjatë vlerësimit të situatës së përgjithshme në secilin prej vendeve, nën-çështjet vijuese janë adresuar në fushën e gjyqësorit:

#### ***Korniza strategjike dhe buxheti***

Kjo përfshinë shkallën në të cilën vendi është në gjendje që me efikasitet t'i identifikojë mangësitë dhe të zhvillojë vizion koherent për mënyrën e adresimit të tyre, përfshirë mënyrën e trajtimit të radhitjes së reformave, nëse organet përgjegjëse dhe kompetencat e tyre janë identifikuar si duhet, nëse ekziston buxhet real, nëse ekziston një mekanizëm për monitorim.

#### ***Menaxhimi i gjyqësorit***

Kjo përfshinë funksionimin e këshillave gjyqësore dhe prokuroriale dhe çështjes që ka të bëjë me përbërjen dhe përzgjedhjen e tyre (të përziera ose jo, të zgjedhur nga bashkëmoshatarët, etj.), pavarësia, mandati, rregullat procedurale, llogaridhënia, transparencja dhe nëse ato kanë buxhet dhe personel të mjaftueshëm.

#### ***Pavarësia***

Kjo përfshinë garantuesit ligjor dhe masat mbrojtëse dhe shkallën në të cilën ato respektohen në praktikë, mënyrën se si ndahen lëndët ndërmjet gjyqtarëve, pyetjet rreth palëvizshmërisë.

#### ***Llogaridhënia***

Kjo përfshinë çështjet si kodet e etikës, trajnimi i integritetit, sistemet për deklarimet e pasurive dhe mënyrën se si kontrollohen ato, puna e autoriteteve të pavarura të inspektimit, shkalla në të cilën merren masa disiplinore efikase në rast nevojë.

#### ***Profesionalizmi dhe kompetenca***

Kjo përfshinë shqyrtimin e sistemeve për rekrutim, përzgjedhje, emërim, promovim dhe vlerësim të zyrtarëve gjyqësorë si dhe zhvillimit dhe trajnimit profesional.

### ***Cilësia e drejtësisë***

Kjo përfshinë promovimin e trajnimit, monitorimin dhe vlerësimin e aktivitetëve të gjykatës, buxhetin dhe burimet, disponueshmërinë dhe shfrytëzimin e informatave dhe të teknologjive informative, metodat për zgjidhje alternative të kontesteve, shkallën në të cilën jurisprudenca është konsistente dhe nëse kjo është në dispozicion për publikun.

### ***Efikasiteti***

Kjo përfshinë adresimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore, numrin e lëndëve të zgjidhura, lëndët e prapambetura, rishikimin/ndryshimin e kodeve të procedurës, riorganizimin e rrjetit të gjykatave/strukturave të gjykatave, ekzistimin e strategjive të burimeve njerëzore, disponueshmërinë e personelit mbështetës, etj.

## **➤ LUFTIMI I KORRUPSIONIT**

Në të gjitha vendet në zgjerim ekziston nevoja për krijimin e kornizave më të fuqishme për ta parandaluar dhe luftuar me efikasitet korrupsionin. Në fushat e cënueshme, siç janë prokurimi publik dhe në privatizim, praktikat korruptive vazhdojnë ta ndërrojnë drejtimin e burimeve të pakta nga buxhetet kombëtare, që ndikojnë negativisht në klimën e biznesit dhe të investimeve, gjë që kërkon zhvillim të sigurisë ligjore. Korrupsioni i prek drejtpërdrejt edhe qytetarët gjatë qasjes në disa shërbime publike, siç janë arsimi dhe shërbimet shëndetësore. Nevojitet kontroll efikas i financimit të partive politike dhe fushatave parazgjedhore, si edhe menaxhim i konfliktit të interesit. Transparenca në shfrytëzimin e fondeve publike dhe një sistem solid për qasjen e publikut në informata janë mjete parandaluese, të cilat duhet të shfrytëzohen plotësisht.

Ekziston nevoja për zbatim më proaktiv, të koordinuar mirë dhe efikas të ligjit për të siguruar që rastet e korrupsionit, përfshirë ato të nivelit të lartë, të hetohen, të ndiqen penalisht dhe të sanksionohen si duhet, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve. Do të nevojitet një regjistër i qëndrueshëm i shënimeve për rezultatet konkrete në këtë fushë. Nevojiten përmirësime në mbledhjen e të dhënave dhe në qasje për të përmirësuar transparencën dhe për të ndihmuar monitorimin e zbatimit të politikave kundër korrupsionit.

Gjatë vlerësimit të situatës së përgjithshme në secilin prej vendeve, nën-çështjet vijuese janë adresuar në fushën e luftës kundër korrupsionit:

### ***Korniza strategjike***

Kjo përfshinë vlerësimin nëse ekzistojnë strategji gjithëpërfshirëse dhe plane të veprimit të besueshme dhe adekuate për të adresuar mangësitë kryesore, se buxheti për to është ndarë si duhet, ekzistimin e mekanizmit të përshtatshëm për monitorim si dhe plane sektoriale të veprimit të dedikuara për sektorë të cënueshëm.

### ***Korniza ligjore***

Kjo përfshinë nevojën për përkufizime të qarta dhe gjithëpërfshirëse ligjore, përfshirë përputhshmërinë me Konventën e OKB-së Kundër Korrupsionit, harmonizimin me rekomandimet GRECO të Këshillit të Evropës, rregullat e qarta dhe sanksionet kufizuese për financimin e partive, konfliktet e interesit, deklaratimet e pasurive dhe qasjen në informata, si edhe një politikë të shëndoshë të burimeve njerëzore për nëpunësit dhe zyrtarët civilë publikë dhe mbrojtjen e informatorëve.

### ***Korniza institucionale - parandalimi***

Kjo përfshinë ekzistimin e organeve të pavarura kundër korrupsionit, autoritetet e krijuara për të monitoruar përputhshmërinë me legjislacionin për parandalim dhe çështjeve që kanë të bëjnë me personelin, trajnimin, buxhetin dhe pavarësinë; ekzistimin e kodeve të etikës, rolin e kontrollit dhe auditimit të brendshëm dhe aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit.

### ***Korniza institucionale – ndalimi***

Kjo përfshinë vlerësimin e mandatit dhe pavarësisë së organeve për zbatimin e ligjit, nivelin e specializimit të tyre, bashkëpunimin në mes të policisë dhe prokurorisë, nëse aplikohen sanksione kufizuese, komunikimin dhe bazën e të dhënave të sigurt, trajtimin e dispozitave për imunitetin.

### ***Rezultatet (regjistri i shënimeve)***

Kjo përfshinë numrin dhe natyrën e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare për rastet e korrupsionit, përfshirë nivelin e lartë, shkallën deri në të cilën konfiskohen asetet, trajtimin e rasteve të konfliktit të interesit, verifikimin e deklarimeve të pasurisë, shkeljen e rregullave të financimit të partisë, rastet e qasjes në informata, etj.

## ➤ LUFTIMI I KRIMIT TË ORGANIZUAR

Luftimi i krimit të organizuar (dhe korrupsionit) mbetet thelbësor për të luftuar infiltrimin e krimit në sistemet politike, ligjore dhe ekonomike. Organet për zbatimin e ligjit dhe shërbimet prokuroriale duhet të pajisen me mjete efektive ligjore dhe hetuese, në mënyrë që ta luftojnë dhe sanksionojnë si duhet krimin e organizuar dhe për të siguruar hetime proaktive. Kapaciteti për të bashkëpunuar, për shembull për të kryer hetime komplekse financiare si dhe për të trajtuar shpëlarjen e parasë, ka nevojë që të përmirësohet në mënyrë thelbësore. Kërcënimet në rritje, siç janë krimet kibernetike dhe terrorizmi, kërkojnë shkallë më të lartë të specializimit. Konfiskimi i aseteve kriminale është kyç për të shpartalluar me efikasitet rrjetet kriminale. Vëmendje duhet t'i kushtohet pasurimit të paligjshëm nëpërmjet veprimeve kriminale, në mënyrë që të adresohet fenomeni i prejardhjes së pasurisë. Gjithashtu nevojitet mbrojtje solide e dëshmitarëve.

Natyra ndërkufitare e shumë aktiviteteve kriminale dhe grupeve të krimit të organizuar kërkon bashkëpunim të avancuar rajonal dhe ndërkombëtar, me përgjigje të përmirësuara ndaj kërkesave të shteteve anëtare lidhur me bashkëpunimin e policisë dhe gjyqësorit. Është i domosdoshëm edhe bashkëpunimi i mëtutjeshëm operativ me agjencitë relevante evropiane, në veçanti me Europol-in, Eurojust-in dhe Frontex-in

Gjatë vlerësimit të situatës së përgjithshme në secilin prej vendeve, nën-çështjet vijuese janë adresuar në fushën e luftës kundër krimit të organizuar:

### ***Korniza strategjike***

Kjo përfshin ekzistimin e një strategjie gjithëpërfshirëse dhe të besueshme, reflektimin e një pasqyre strategjike të situatave të krimit të organizuar, bazuar në analizën e rrezikut si dhe çfarëdo strategjie tjetër për llojet specifike të krimit ose hetimeve financiare.

### ***Korniza ligjore***

Kjo përfshin sigurimin e ekzistimit të një kodi adekuat të procedurës penale dhe se kodi penal është në harmoni me *acquis* (trafikimi, drogat, krimet kibernetike, pornografia me fëmijë).

### ***Korniza institucionale***

Kjo përfshin shqyrtimin e numrit të policisë, trajnimin dhe profesionalizmin e tyre, specializimin për zbatimin të ligjit, përfshirë shërbimin e prokurorisë, bashkëpunimin ndërkombëtar, punën e rikthimit të aseteve dhe menaxhimin e zyrës, sistemet e mbrojtjes së dëshmitarëve, si dhe mekanizmat për mbikëqyrjen e policisë.

### ***Kapaciteti operativ (regjistri i shënimeve)***

Kjo përfshin numrin dhe natyrën e hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve përfundimtare për rastet e krimit të organizuar, përfshirë shkallën e shënjestrimit të organizatave kriminale (e jo vetëm individët) shkallën deri në të cilën konfiskohen asetet, sistemet e unifikimit, bazat e të dhënave, personelin dhe pajisjet, fshehtësinë e hetimeve dhe aktivitetet kundër shpëlarjes së parave.

## ➤ LIRIA E SHPREHJES

Korniza ligjore për lirinë e shprehjes dhe të medieive kryesisht ekziston në vendet në zhvillim, me pluralizëm të medieive që kryesisht është evident. Megjithatë, situata sa i përket lirisë së shprehjes dhe të medieive në praktikë mbetet një çështje e shqetësimit serioz dhe ka vazhduar të përkeqësohet në disa vende. Në disa vende, klima e frikës dhe censurës ushqehet përmes dhunës dhe kërcënimit të vazhdueshëm ndaj gazetarëve, me pak sukses të autoriteteve që të identifikojnë dhe sanksionojnë në mënyrë të duhur keqbërësit, si edhe me pak vullnet politik për ta bërë këtë. Nganjëherë vetë qeveritë kontribuojnë për një atmosferë që i demonizon gazetarët që janë kritikë ndaj politikave të qeverisë, gjë që shpie drejt vetë-censurimit. Edhe pse shpifja është dekriminalizuar, ndjekja penale e gazetarëve vazhdon. Ekziston nevoja për të zhvilluar dhe trajnuar gjyqësorin që të adresojë abuzimin me pushtetin.

Ndërhyrja e qeverisë në lirinë e medieive mbetet për t'u adresuar. Nevojiten më shumë përpjekje për të siguruar pavarësi politike dhe financiare të transmetuesve publikë, për të forcuar agjencitë rregullative dhe për të nxitur vetë-rregullimin funksional të medieive. Gjithashtu, ekziston nevoja për të parandaluar presionin joformal ekonomik ndaj medieive, përfshirë rritjen e transparencës për pronësinë e medieive, duke parandaluar përqendrimin e shtuar të saj dhe duke siguruar se ekzistojnë rregulla transparente për prokurimin e reklamave qeveritare.

Gjatë vlerësimit të situatës së përgjithshme në secilin prej vendeve në zgjerim, nën-çështjet vijuese janë adresuar në fushën e lirisë së shprehjes<sup>7</sup>:

### ***Kërcënimi i gazetarëve***

Kjo përfshin vlerësimin e mënyrës se si përcillen sulmet fizike dhe kërcënimet ndaj gazetarëve nga ana e policisë dhe organeve gjyqësore; çështjen e arrestimit arbitrar të gazetarëve dhe deklaratat e politikanëve, të cilat mund të kenë efekt "frikësues" te gazetarët dhe kontribuojnë në një mjedis të vetë-censurimit.

### ***Mjedisi legjislativ***

Kjo përfshin vlerësimin e proporcionalitetit të rregullave ligjore për shpifje, blasfeminë, gjuhën e urrejtjes, moralin publik dhe mbrojtjen e sigurisë shtetërore në mediet elektronike dhe të shkruara, rregullimi i profesionit të gazetarit si dhe kufizimet për qasje në informata.

### ***Zbatimi / institucionet***

Kjo përfshin vlerësimin e shkallës në të cilën aplikohen rregullat në mënyrë konsistente dhe puna e rregullatorëve të medieive të pavarura. Gjithashtu, përfshin kufizimet në internet dhe operatorë, trajtimin e pronës intelektuale, të drejtën e privatësisë dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave.

### ***Faktorët ekonomikë***

Kjo përfshin shkallën në të cilën ekziston pluralizmi i medieive, transparencën e pronësisë së medieive, transparencën e shfrytëzimit të parasë publike në medie, financimin e transmetuesve publikë dhe çështjen e reklamimit nga ana e qeverisë dhe mënyrën se si kjo ndikon te mediet.

### ***Shoqatat profesionale dhe kushtet e punësimit***

Kjo përfshin organet profesionale, përfaqësimin e gazetarëve dhe gjendjen e punësimit të tyre dhe kushtet e punës.

<sup>7</sup> Çështjet kyçe gjithashtu adresohen në *Udhërrëfyesit për mbështetjen e BE-së për liri të medieive dhe integritet të medieive në vendet në zgjerim, 2014-2020* ([http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press\\_corner/elarg-guidelines-for-media-freedom-and-integrity\\_210214.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/press_corner/elarg-guidelines-for-media-freedom-and-integrity_210214.pdf)).

## ➤ REFORMA E ADMINISTRATËS PUBLIKE

Reforma e administratës publike (RAP) synon të avancojë transparencën, llogaridhënien e efikasitetin dhe fokusin më të madh lidhur me nevojat e qytetarëve dhe bizneseve. Menaxhimi adekuat i burimeve njerëzore, planifikimi më i mirë i politikave, koordinimi dhe zhvillimi, procedurat e shëndosha administrative dhe menaxhimi i përmirësuar i financave publike, përfshirë administrimin e të hyrave dhe arkëtimin, kanë rëndësi thelbësore për funksionimin e shtetit dhe zbatimin e reformave të nevojshme për integrim në BE. Vendet në zgjerim kanë nevojë të shtojnë përpjekjet e tyre për të përmirësuar administratën e tyre publike në të gjitha nivelet, në bazë të strategjive kombëtare. Duke njohur sfidat më të cilat përballen vendet në zgjerim, Komisioni është duke forcuar përkrahjen për krijimin e strukturave të nevojshme administrative dhe të kapaciteteve gjatë procesit të anëtarësimit. Komisioni vazhdon t'i kushtojë kujdes të theksuar RAP-it gjatë procesit të zgjerimit, edhe përmes krijimit të 'grupeve speciale' për vendet e Ballkanit Perëndimor, si një platformë kyçe për ta çuar përpara punën e RAP-it. Kjo punë i jep Këshillit / Komitetit të MSA-së diskutim më të strukturuar politik për çështjet kyçe të RAP-it.

Gjatë vlerësimit të situatës së përgjithshme në secilin prej vendeve, nën-çështjet vijuese janë adresuar në fushën e reformës së administratës publike:

### ***Korniza strategjike***

Kjo përfshin përkushtimin politik për procesin e reformimit, përfshirë lidhshimin politik dhe koordinimin teknik dhe monitorimin e zbatimit.

### ***Zhvillimi i politikave dhe koordinimi***

Kjo përfshin koordinimin në nivel të qeverisë qendrore, koordinimin në nivel ndër-ministor, zhvillimin e politikave dhe analizën financiare.

### ***Shërbimi publik dhe menaxhimi i burimeve njerëzore***

Kjo përfshin organizimin dhe funksionimin e shërbimit publik, përfshirë depolitizimin, rekrutimin e bazuar në meritë dhe promovimin, trajnimin dhe profesionalizmin.

### ***Llogaridhënia***

Kjo përfshin transparencën e administratës, përfshirë qasjen në informata dhe mundësinë për korrigjim administrativ dhe ligjor.

### ***Ofrimi i shërbimeve***

Kjo përfshin përmirësimin e shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, përfshirë procedura më të mira administrative dhe shërbime të e-qeverisjes.

### ***Menaxhimi i financave publike (MFP)***

Kjo përfshin menaxhimin e financave publike dhe procesit të përgjithshëm buxhetor, përmes përgatitjes dhe zbatimit të programeve shumëvjeçare të MFP-së dhe angazhimin në një dialog politik për MFP-në me Komisionin dhe Institucionet Financiare Ndërkombëtare.



## ➤ KRITERET EKONOMIKE

Kriteret ekonomike të Kopenhagës për anëtarësim në BE kërkojnë 1) ekzistimin e një ekonomie të tregut dhe 2) kapacitetin që të ballafaqohet me presionet e konkurrencës dhe në fuqinë e tregut të Bashkimit Evropian. Për secilin nga kriteret ekonomike, Komisioni monitoron një sërë nën-kriteresh që ishin specifikuar si pjesë e pakos së Agjendës 2000, të publikuar në vitin 1997, në kontekstin e përgatitjeve për anëtarësimin e shteteve anëtare, të cilat pastaj iu bashkuan BE-së në vitet 2004/2007.

*Një ekonomi funksionale e tregut kërkon:*

- ekzistimin e një konsensusi të gjerë për çështjet themelore të politikës ekonomike;
- stabilitet makroekonomik (përfshirë stabilitetin e çmimeve, gjendjen e qëndrueshme financiare dhe llogaritë e jashtme);
- një bashkëveprim të lirë të forcave të tregut (përfshirë çmimet dhe tregun e liberalizuar);
- hyrje dhe dalje të lirë në treg (përfshirë çështjet e themelimit/falimentimit të firmave); dhe
- një sistem adekuat ligjor (përfshirë një sistem të drejtave pronësore, zbatueshmëri të ligjeve/kontratave) dhe një sektor financiar të zhvilluar mjaftueshëm.

Kriteri i dytë ekonomik është kapaciteti për t'u bërë ballë presioneve të konkurrencës dhe fuqisë së tregut brenda Bashkimit. Kjo do të kërkojë një nivel minimal të konkurrencës së ekonomive të vendeve kandidate, posa vendi t'i bashkohet BE-së, kështu që, sipas përcaktimit, kriteri është më *progresiv* për nga natyra.

*Të jesh konkurrues në BE kërkon:*

- ekzistimin e një ekonomie funksionale të tregut;
- kapital të mjaftueshëm njerëzor dhe fizik (përfshirë çështjet e arsimit, hulumtimit dhe infrastrukturës);
- strukturë adekuate sektoriale dhe të ndërmarrjeve (përfshirë çështjet e ristrukturimit të ndërmarrjeve, ndërrimin sektorial, rolin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme);
- ndikim të kufizuar të shtetit në konkurrencë (përfshirë çështjet e politikave tregtare, politikave të konkurrencës, ndihmave të shtetit, përkrahje për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, etj.); dhe
- integrim të mjaftueshëm tregtar dhe investues me BE-në.

Këto nën-kritere nuk ofrojnë një listë të thjeshtë që do të vlerësonte përputhshmërinë. Plotësimi i kritereve ekonomike kërkon reforma strukturore të thella dhe të qëndrueshme, të cilat marrin kohë për t'u përmbushur. Kjo nënvizon rëndësinë e ekzistimit të një regjistri të qëndrueshëm që përcjell zbatimin e reformave, të tillë që do të shkaktojë ndryshim të përherëshëm dhe të pakthyeshëm në pritjet dhe sjelljet e agjentëve ekonomikë.

## ➤ Kapitulli 5: PROKURIMI PUBLIK

*acquis* në prokurimin publik bazohet në parimet e përgjithshme të traktatit të BE-së për trajtim të barabartë, mosdiskriminim, proporcionalitet dhe transparencë. Tri direktivat e BE-së mbulojnë procedurat e zbatueshme të prokurimit të autoriteteve kontraktuese në sektorin klasik, entitetet në sektorin e ndërmarrjeve dhe koncesionet. Për më tepër, një direktivë specifike e BE-së aplikohet në fushën e mbrojtjes e të sigurisë. Aplikohet edhe një direktivë për rishikimin e procedurave, e cila plotësohet me pjesë të tjera teknike të legjislacionit.

Në vlerësimin e situatës së përgjithshme, në secilën prej vendeve, në fushën e prokurimit publik janë adresuar nën-çështjet vijuese:

### ***Përafrimi ligjor***

Kjo përfshin sigurimin që rregulloret e prokurimit (përfshirë koncesionet) janë të përafuara me *acquis*, bazuar në parimet e përgjithshme të trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, proporcionalitetit dhe transparencës, dhe janë të fuqizuara mjaftueshëm.

### ***Korniza institucionale***

Kjo përfshin sigurimin që ka kapacitetet administrative dhe institucionale qendrore për të zhvilluar, implementuar dhe monitoruar politikën e prokurimit në mënyrë efektive dhe efikase, si e dhe një institucion të veçantë përgjegjës për rishikim ligjor të procedurave të prokurimit publik.

### ***Kapaciteti për zbatim***

Kjo përfshin sigurimin që autoritetet kontraktuese dhe entitetet kanë kapacitetet e duhura dhe udhëzimet praktike e mjetet për të siguruar menaxhimin profesional të gjithë ciklit të prokurimit.

### ***Kapaciteti për implementim dhe zbatim***

Kjo përfshin sigurimin që operacionet e prokurimit publik janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me parimet bazë, derisa sigurohet shfrytëzimi më efikas i fondeve publike dhe shfrytëzimi më i mirë i teknikave dhe metodave moderne të prokurimit. Rekomandohet që vendet të kenë sisteme për monitorimin e proceseve të prokurimit publik që nga tenderimi fillestar e deri te kontrata përfundimtare. Kjo duhet të mundësojë shqyrtim më të mirë të ofertave në të gjitha fazat, përfshirë edhe fazën finale, krahasuar me ofertën e pranuar fillimisht.

### ***Sistemi efikas i rregullimit***

Kjo përfshin sigurimin që sistemi i rregullimit është i përafuar me standardet e *acquis* për pavarësi, ndershmëri dhe transparencë dhe siguron trajtim të shpejte dhe kompetent të ankesave dhe sanksioneve.

## ➤ Kapitulli 18: STATISTIKAT

*acquis* në fushën e statistikave kërkon një sistem statistikor të bazuar në parimet, si pavarësinë profesionale, paanësinë, besueshmërinë, cilësinë, transparencën, konfidencialitetin e të dhënave individuale dhe shpërndarjen e statistikave zyrtare. Këto parime janë të përcaktuara në Kodin e praktikës së statistikave evropiane. Institutet Kombëtare të Statistikave (IKS-të) veprojnë si referenca dhe lidhin pikat për metodologjinë, krijimin dhe shpërndarjen e informatave statistikore. *acquis* mbulon metodologjinë, klasifikimet dhe procedurat për mbledhjen e të dhënave në fusha të ndryshme si statistikat makroekonomike, statistikat sociale, statistikat afariste, statistikat bujqësore dhe statistikat për mjedis dhe energji. Nuk ka nevojë për zhvendosje në legjislacionin kombëtar, meqë pjesa më e madhe e *acquis* ka formën e rregulloreve.

Në vlerësimin e situatës së përgjithshme në secilin prej vendeve, në fushën e statistikave janë adresuar nën-çështjet vijuese:

### ***Infrastruktura statistikore***

Kjo përfshin ligjin për statistika, burimet e IKS-ve, koordinimin e Sistemit Statistikor Kombëtar, implementimin e Kodit të praktikës së statistikave evropiane, klasifikimin dhe regjistrimin.

### ***Statistikat makro-ekonomike***

Kjo përfshin ecuritë buxhetore kombëtare, vjetore dhe tremujore, përfshirë statistikat financiare dhe llogaritë sektoriale të qeverisë, statistikat e çmimeve, statistikat tregtare, Statistikat e Tregtisë së Filialeve të Huaja (FATS), investimet e huaja direkte, partneritetet publiko-private, llogaritë rajonale, bilanci të pagesave.

### ***Statistikat afariste***

Kjo përfshin statistikat afariste afatshkurtra dhe strukturore, turizmin, transportin, energjinë, statistikat për kërkim dhe zhvillim, inovacionin, shoqërinë informative.

### ***Statistikat sociale***

Kjo përfshin tregun e punës, përfshirë punësimin/papunësinë, shëndetin, arsimin, demografinë, cilësinë e jetës, mbrojtjen sociale, regjistrimin e popullsisë.

### ***Statistikat bujqësore***

Kjo përfshin prodhimet blegtorale dhe bujqësore, çmimet e prodhimeve bujqësore, llogaritë e bujqësisë, strukturën e fermave, regjistrimin bujqësor.

### ***Statistikat mjedisore***

Kjo përfshin mbeturinat, ujin, mbrojtjen e mjedisit, llogaritë e mjedisit, emetimet në ajër etj.

## ➤ Kapitulli 32: KONTROLI FINANCIAR

Ky kapitull përmban fillimisht sigurimin se menaxhimi financiar i të hyrave dhe shpenzimeve kombëtare është në përputhshmëri me kornizat, standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mirë evropiane. Ky kapitull i përket tërë sektorit publik, si edhe në qeverisjen lokale, prandaj është i lidhur plotësisht me reformën e administratës publike. Në këtë kapitull, *acquis* ka të bëjë me miratimin dhe implementimin e masave ligjore dhe institucionale, bazuar në parimet, standardet dhe metodat ndërkombëtare dhe të BE-së që duhet të aplikohen në sistemet e kontrollit të brendshëm të gjithë sektorit publik, si edhe me standardet e kontrollit të jashtëm, ashtu siç është përcaktuar nga Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve të Auditimit Suprem (INTOSAI). Në veçanti, *acquis* kërkon praninë e sistemeve të kontrollit dhe menaxhimit financiar efikas, efektiv dhe transparent dhe; auditimi të brendshëm të pavarur e funksional; harmonizim të centralizuar të metodologjive dhe standardeve; struktura të nevojshme kombëtare dhe një institut shtetëror auditimi të pavarur e funksional, për auditimin financiar institucional të fondeve publike. Ky kapitull, po ashtu, përfshin *acquis* për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së dhe për luftimin e mashtrimeve që përfshijnë fondet e BE-së si dhe aspektet jo-penale të mbrojtjes së euros kundër falsifikimit.

Në vlerësimin e situatës së përgjithshme në secilin prej vendeve, në fushën e kontrollit financiar janë adresuar nën-fushat vijuese:

### ***Kontrolli Financiar i Brendshëm Publik (KFBP)***

Ai përfshin angazhimin për të implementuar KFBP-në në gjithë sektorin publik; duke pasur një strategji shumë-vjeçare për KFBP, e lidhur qartë me RAP të përgjithshëm dhe me strategjinë për menaxhimin e financave publike dhe duke kërkuar implementimin, monitorimin dhe raportimin e saj, si dhe përfshin angazhimin politik. Duhet të krijohet një Njësi Qendrore e Harmonizimit (NQH), me bazë ligjore gjithëpërfshirëse, me staf dhe kapacitet administrativ të mjaftueshëm dhe me rolin e saj si kontribuues i koordinimit dhe udhëzimit metodologjik të zhvillimeve. Çështjet e tjera përfshijnë regjistrimin dhe rishikimin vjetor të cilësisë së menaxhimeve dhe kontrolleve financiare dhe aktivitetit të auditimit të brendshëm.

Korniza ligjore duhet të lehtësojë zhvillimin e llogaridhënies menaxheriale, konsistente me kornizën ligjore që rregullon organizimin e shërbimit publik dhe civil dhe strukturave organizative. Duhet të sigurohen aspektet kryesore të Kontrollit dhe Menaxhimit Financiar. Duhet të krijohet një funksion i auditimit të brendshëm në gjithë sektorin publik, me kapacitetet personeli të mjaftueshëm.

### ***Auditimi i jashtëm***

Kjo përfshin sigurimin e pavarësisë së Institucionit të Auditorit të Shtetit (IASH) me Kushtetutën dhe me legjislacionin përkatës në përputhshmëri me standardet INTOSAI, kapacitetit institucional për të përmbushur mandatin e auditimit, angazhimin për të siguruar cilësi të punës së auditimit financiar dhe të performancës dhe zotimin për të marrë masa që sigurojnë ndikimin e punës së auditimit të jashtëm, përfshirë përcjelljen e gjetjeve të auditimit.

### ***Mbrojtja e interesave financiare të BE-së***

Kjo përfshin sigurimin që legjislacioni është i harmonizuar me Konventën për mbrojtjen e interesave financiare të Komuniteteve Evropiane dhe të *acquis* të tjera përkatëse, krijimin e shërbimit kombëtar për koordinim kundër mashtrimit (AFCOS), krijimin e kapaciteteve të mjaftueshme administrative, bashkëpunim me Komisionin, përfshirë edhe atë të misioneve Ad Hoc të Komisionit, një strukturë për raportim të parregullsisve dhe rasteve të dyshuara për mashtrim.

### ***Mbrojtja e euros nga falsifikimi (aspektet jo-penale)***

Kjo përfshin ratifikimin e Konventës Ndërkombëtare për Parandalimin e Falsifikimit të Valutave të vitit 1929, përafrimin e legjislacionit kombëtar me *acquis*, strukturat administrative, kapacitetet për analizë teknike, klasifikimin e parave falso dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

### SHTOJCA 3 - STATISTIKAT KRYESORE

	Mali i Zi	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	Shqipëria	Serbia	Turqia	Bosnja dhe Hercegovina	Kosova *	BE-28
--	-----------	---------------------------------------	-----------	--------	--------	------------------------	----------	-------

TË DHËNAT STATISTIKORE (me datë 18.09.2015 për vendet kandidate dhe kandidatet potenciale, dhe prej 01.09.2015 për BE-28)

Popullsia	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Popullsia e përgjithshme (mijëra)	1)	620.9	621.5	2 062.3	2 065.8	2 898.8e	2 895.9e	7 183.9e	7 149.2e	75 627	76 668	3 831.6e	3 827.3e	1 820.6e	1 804.9e	505 115p	506 881ep
Hisja e 15-64 në popullsinë e përgjithshme		68.1	68.1	71.0	70.8	68.5	68.8	68.1	67.6	67.6	67.7	67.8e	67.8e	0.1	0.1	66.2p	65.9bep
Norma e ndryshimit të popullsisë natyrore (për 1 000 banorë)		2.5	2.4	1.9	:	5.3	5.2	-4.8	-4.9	12.1	12.2	-1.3	-1.5p	11.9	13.3	0.2ep	0.3ep
Pritjet jetësore në lindje, meshkuj (vjet)		74.1	73.9	73.2	:	76	76.4	72.5	72.6	74.7e	74.8e	73.7e	73.7e	74.2	74.2	77.8	:
Pritjet jetësore në lindje, femra (vjet)		79.0	78.9	77.2	:	80.3	80.3	77.7	77.7	79.2e	79.3e	78.8e	78.8e	79.4	79.5	83.3	:

Bruto Produkti Vendor	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Bruto produkti vendor																	
Në çmime aktuale (miliardë EUR)	7) 8)	3.3	3.4p	8.1p	8.5e	9.6p	10.0p	34.3	33.1e	620.7	601.3	13.7	13.9	5.3	:	13 521	13 920
Për kokë banori (EUR)	7) 8)	5 356	5 436p	3 930p	4 127s	3 323p	3 440p	4 781	4 635e	8 161	7 819	3 569	3 641	2 935	:	26 600	27 300
Në standardet e fuqisë blerëse (SFB) për kokë banori	7) 9)	10 700	10 600p	9 500e	10 000	:	:	9 800	9 500	14 100	14 400	7700	7 800	:	:	26 600	27 300
SFB për kokë banori, lidhur me mesataren e BE-së (BE-28 = 100)	7) 9)	40	39p	36	36	28	29	37	35	53	53	29	28	:	:	-	-
Norma real e ndryshimit, krahasuar me vitin e kaluar (%)	7)	3.3	:	2.7p	3.8e	1.1p	2.1p	2.6	-1.8e	4.2	2.9	2.5	1.1	3.4	:	0.1	1.3

Financat publike	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Statistikat financiare të qeverisë, lidhur me BPV																	
** Deficiti/suficiti (+)/(-) i përgjithshëm qeveritar (%)	12)	-2.3	-3.1	-3.9	-4.2	-4.9	-5.1	-5.5	-6.7	0.2	:	-2.2	:	:	:	-3.2	-2.9
** Borxhi i përgjithshëm qeveritar (%)	12) 13)	58.0	56.7	34.2	38.2	70.1	71.8	59.0	68.9	36.0	:	:	:	9.0e	:	85.5	86.8

		Mali i Zi	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	Shqipëria	Serbia	Turqia	Bosnja dhe Hercegovina	Kosova *	BE-28								
Aktiviteti ekonomik dhe punësimi	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Norma e aktivitetit ekonomik për personat e moshës 20-64 vjeç: hisja e popullsisë së moshës 20-64 ekonomikisht aktive (%), gjithsej		65.1	67.6	70.4	70.8	67.6e	68.6e	66.0	66.2	58.4	58.9b	58.7	59.2	46.4	47.7	76.5	76.9
- Meshkuj		71.9	74.5	83.4	84.5	79.2e	80.5e	75.3	75.1	81.6	:	72.1	72.4	69.5	71.4	83.0	83.2
- Femra		58.3	60.7	57.1	56.8	57.6e	57.3e	56.8	57.5	35.6	:	45.1	46.0	23.7	24.2	70.0	70.6
Normat e punësimit, të moshës 20-64 vjeç (% e popullsisë), gjithsej		52.6	55.6	50.3	51.3	56.7e	56.6e	51.2	53.5	53.4	53.2b	42.8	43.2	33.0	31.3	68.4	69.2
- Meshkuj		57.8	61.4	59.7	61.6	64.8e	65.2e	59.5	61.2	75.3	75.0b	53.3	54.6	51.5	48.4	74.3	75.0
- Femra		47.5	49.4	40.7	40.8	49.3e	48.5e	43.1	46.0	31.8	31.6b	32.2	31.9	14.9	14.5	62.6	63.4
Personat e moshës 15-24 vjeç që nuk janë të punësuar, të arsimuar ose trajnuar, % e popullsisë në moshën grupore		17.8	17.7	:	:	30.8e	30.9e	22.9	23.5	:	:	25.8	26.1	:	:	13.0	12.4
Punësimi sipas sektorëve kryesorë																	
- Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (%)	2)	4.5	5.7	18.7	18.0	44.0e	42.7e	21.3	21.1	23.6	21.1b	18.9	17.1	5.9	2.6	4.8	4.7
- Industria (%)	2)	11.9	11.1	23.5	23.5	9.7e	11.0e	21.1	20.0	19.4	20.5b	22.2	22.1	16.8	17.7	17.3	17.3
- Ndërtimtaria (%)	2)	5.9	6.5	6.9	7.0	7.1e	6.4e	4.8	4.4	7.0	7.4b	7.7	7.9	11.4	10.9	6.9	6.8
- Shërbimet (%)	2)	77.7	76.7	50.6	51.4	38.8e	39.4e	52.9	54.5	50.0	51.0b	51.0	52.7	64.1	67.2	70.3	70.5
Personat e punësuar në sektorin publik si hise e punësimit të përgjithshëm, personat e moshës 20-64 vjeç (%)	3)	:	32.8	:	:	17.8e	17.5e	32.6	31.6	13.5	13.1b	32.7	31.9	:	31.4s	:	:
Personat e punësuar në sektorin privat si hise e punësimit të përgjithshëm, personat e moshës 20-64 vjeç (%)	3)	:	48.2	:	:	82.2e	82.5e	65.2	66.4	86.5	86.9b	62.5	63.1	:	68.6s	:	:
Shkalla e papunësisë (% e fuqisë punëtore), gjithsej	4)	19.5	18.0	29.0	28.0	15.9e	17.5e	22.1	18.9	8.8	9.9b	27.6	27.6	30.0	35.3	10.8	10.2
- Meshkuj	4)	20.1	17.8	29.0	27.7	17.8e	19.2e	20.8	18.3	8.0	9.1b	26.7	25.3	26.9	33.1	10.8	10.1
- Femra	4)	18.8	18.2	29.0	28.6	13.5e	15.2e	23.8	19.6	10.6	11.9b	29.1	31.2	38.8	41.6	10.9	10.3
- Të rinjtë, të moshës 15-24 vjeç	4)	41.6	35.8	51.9	53.1	31.4e	39.0e	49.4	47.1	16.9	17.8b	59.1	62.7	55.9	61.0	23.6	22.2
- Afatgjatë (>12 muaj)	4)	16.0	14.0	23.9	:	11.5e	11.2e	16.8	12.8	2.1	2.4b	22.9	23.4	20.7	26.1	5.1	5.1
Pagat mesatare mujore (EUR)	5)	487	479	343.5	:	371.8	378.8	536.6	523.6	:	:	422.8	424.4	:	:	:	:

		Mali i Zi		Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë		Shqipëria		Serbia		Turqia		Bosnja dhe Hercegovina		Kosova *		BE-28	
	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Arsimi																	
Braktisja e hershme e arsimit dhe trajnimit: përqindja e popullsisë së moshës 18-24 vjeç me më së shumti arsim të mesëm dhe pa arsimim dhe trajnim të mëtejshëm (%)	6)	5.1	5.1	11.4	12.5	30.6e	26.0e	8.7	8.3	37.6p	38.3b	25.9	25.2	:	:	11.9	11.1b
Përqindja popullore të moshës 20-24 vjeç me arsim të ulët sekondar, gjithsej		:	86.3	:	:	44.2e	49.7e	83.2	82.5	:	:	85.8	85.6	69.5	68.2	:	:
- Meshkuj		:	87.8	:	:	48.0e	55.9e	85.7	84.7	:	:	87.7	89.6	73.4	71.8	:	:
- Femra		:	84.7	:	:	40.3e	43.5e	80.3	80.1	:	:	83.5	81.2	65.1	64.0	:	:
Përqindja e popullsisë së moshës 30-34 vjeç me arsim të lartë, gjithsej		28.0	28.3	:	:	15.7e	16.7e	25.3	27.2	:	:	15.7	18.9	12.0	16.6	37.0	37.8b
- Meshkuj		24.7	25.3	:	:	12.7e	14.0e	20.2	21.8	:	:	14.6	15.2	9.9	13.0	32.7	33.4b
- Femra		31.5	31.3	:	:	18.3e	19.2e	30.5	32.6	:	:	16.8	23.2	14.2	14.8	41.3	42.2b
Vlera e shtuar bruto	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Vlera e shtuar bruto nga sektorët kryesorë																	
- Bujqësia, pylltaria dhe peshkataria (%)	7) 10)	9.8	:	11.0p	10.2e	22.5p	22.6p	9.4	9.7e	7.4	7.1	8.0	7.1	14.4	:	1.7	1.6
- Industria (%)	7) 10)	13.8	:	17.9p	18.0e	14.4p	14.2p	26.6	24.6e	19.1	19.5	21.6	21.3	20.3	:	19.1	18.9
- Ndërtimtaria (%)	7) 10)	5.0	:	6.6p	6.8e	11.9p	11.0p	5.1	5.2e	4.4	4.6	4.5	4.7	7.9	:	5.4	5.4
- Shërbimet (%)	7) 10)	71.4	:	64.4p	65.0e	51.1p	52.2p	59.0	60.5e	57.6	57.7	65.9	66.9	57.4	:	73.8	74.1
Tregtia ndërkombëtare	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Tregtia ndërkombëtare në mallra dhe shërbime krahasuar me BPV																	
- Importi (% e BPV)	7) 11)	62.1	:	61.9p	65.1e	53.5p	49.0p	51.9	54.3e	32.2	32.1	49.8	:	49.0	:	40.3	40.2
- Eksporti (% e BPV)	7) 11)	41.8	:	43.8p	47.9e	35.4p	29.9p	41.2	44.3e	25.6	27.7	30.0	:	17.4	:	42.9	43.0
Hisja e eksportit për vendet e BE-28 në vlerë të eksportit të përgjithshëm (%)		41.5	35.8	72.6	76.6	76.7	77.4	63.8	65.7	41.5	43.5	73.5	72.1	43.5	30.2	-	-
Hisja e importit nga vendet e BE-28 në vlerë të eksportit të përgjithshëm (%)		44.2	45.8	62.7	63.5	64.3	61.1	55.7	57.1	36.7	36.7	60.0	58.9	44.7	42.6	-	-
Bilanci tregtar (milionë EUR)		-1 398	-1 451	-1 748	-1 762	-1 938	-2 114	-2 933	-2 950	-75 250	-63 628	-3 472	-3 843	-2 148	-2 214	51 565	22 383

		Mali i Zi	Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë	Shqipëria	Serbia	Turqia	Bosnja dhe Hercegovina	Kosova *	BE-28								
Inflacioni dhe interesi	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Ndryshimi vjetor në çmimet e konsumatorit (%)		2.2	-0.7	2.8	-0.3	1.9	0.7	7.8	2.9	7.5	8.9	-0.2s	:	1.8	0.4	1.5	0.6
Gjithsej borxhi i jashtëm, krahasuar me BPV (%)	14)	:	:	64.3	69.8p	61.1	65.2	75.1	78.1	:	:	:	:	30.2	32.3	:	:
Norma e interesit në kredi (një vit), për vit (%)	15)	9.36	9.22	3.75	3.75	9.52	7.66	12.00	10.50	:	:	6.99	6.64	12.36	10.70	:	:
Norma e interesit në depozita (një vit) në vit (%)	16)	2.54	1.86	0.75	0.50	4.17	1.92	7.00	5.50	:	:	0.13	0.10	3.39	1.07	:	:
Vlera e pasurive rezervë (përfshirë arin) (milionë euro)	17)	424	545	1 993	2 436	2 015	2 192	11 189	9 907	:	:	3 614	4 001	724	746	:	:
Rezervat ndërkombëtare – në barasvlerë me muajt e importit	17)	2.5	3.2	4.8	5.3	5.2	5.5	7.5	6.6	:	:	5.8	6.0	3.3	3.2	:	:
Remitencat si % e BPV	18)	1.2	1.3	2.2	2.2	:	:	8.3	7.9	:	:	8.2	8.4	:	:	:	:
Investimi	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Investimet e huaja direkte neto (hyrje-dalje) (IHD) (milionë euro)	18)	323.9	353.9	263.8	278.0	923.2	801.3p	768.5	1 236.3	:	:	224.7	422.4	250.2	123.8	-19 340	-19 350
Investimet e huaja direkte neto (hyrje-dalje) (IHD) (% e BPV)	18)	9.7	:	3.3	3.3	9.6	8.0p	2.2	3.7	:	:	1.6	3.0	4.7	:	-0.14	-0.14
Prodhimi industrial	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Indeksi i prodhimit industrial (2010 = 100)	19)	92.3	81.8	107.4	112.5	135.1	138.9	105.6	98.8	116.3	120.5	103.4	103.6	:	:	100.4	101.5
Lidhja	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Densiteti i rrjetit hekurudhor (linjat në operim për mijëra km <sup>2</sup> )		18.1	18.1	27	27	12.0	12.0	49.3	49.3	12.4	12.8	20.1	:	31.0	31.0	:	:
Gjatësia e autostradave (kilometra)		0	0	259	259	:	:	607	607	2 127	2 155	50	:	80	80	:	:
Importet e energjisë	Shenim	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014	2013	2014
Importet neto të energjisë në raport me BPV	20)	-0.1	:	3.6	3.1	0.8	:	5.3	5.4e	6.8	6.9	7.5p	:	1.5	:	2.8	2.4



:= nuk është në dispozicion  
b = ndarje në seri  
e = vlerë e përafërt  
p = e përkohshme  
s = vlerësim i përafërt i Eurostat  
- = nuk është e aplikueshme

\* = Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet për statusin dhe është në përputhje me Rezolutën e OKB-së 1244/1999 dhe opinionin e GJND-së mbi deklaratën e pavarësisë së Kosovës.

\*\* = Deficiti qeveritar dhe të dhënat për borxhin e vendeve në zgjerim janë publikuar ashtu siç janë, pa ndonjë siguri sa i përket cilësisë dhe zbatimit të rregullave të ESA-s..

Fusnotat:

- 1) Bosnja e Hercegovina: popullsia në mes të vitit.
- 2) Shqipëria: shuma e hiseve nuk jep vlerën 100% për shkak të rasteve ku personat nuk kanë qenë të klasifikuar ose nuk mund të klasifikohen për një aktivitet të caktuar.
- 3) Bosnja e Hercegovina: hiset nuk japin vlerën 100% për shkak se llojet e tjera të pronësisë janë përjashtuar. Mali i Zi: me përjashtim të OJQ-ve.
- 4) Turqia: papunësia është bazuar në kriterin e 4 javëve + me përdorimin vetëm të metodave për kërkimin e punëve aktive.
- 5) Serbia, 2013: pagat dhe pagesat e punëtorëve të entiteteve ligjore dhe të ndërmarrjeve të pakorporatizuara. Bosnja e Hercegovina: paga neto.
- 6) Turqia: rezultatet vjetore të LFS.
- 7) Shqipëria, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia dhe BE-28: bazuar në ESA2010.
- 8) Mali i Zi, 2014: burimi, Eurostat.
- 9) Mali i Zi, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Shqipëria, Serbia, Turqia dhe Bosnja e Hercegovina (vetëm në 2013): llogaritjet e Eurostat.
- 10) Turqia: llogaritjet si hise e vlerës së shtuar plus taksat dhe subvencionet minus FISIM; prandaj hiset nuk e japin shumën 100%.
- 11) Bosnja e Hercegovina: hiset janë në krahasim me BPV, llogaritjet me anë të një qasjeje shpenzimesh. Shqipëria: hiset e komponentëve të shpenzimeve të BPV nuk përfshijnë mospërrputshmërinë statistikore (hiset për të gjitha komponentët nuk e përbëjnë shumën 100%).
- 12) BE-28: bazuar në ESA 2010.
- 13) Kosova, 2013: vlera e BPV është marrë nga Korniza Afatmesme e Shpenzimeve 2016-2018 (prill 2015).
- 14) Shqipëria: të dhënat për borxhin e jashtëm bruto janë dhënë nga Banka e Shqipërisë. Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: bazuar në manualin e bilancit të pagesave, edicioni i 6të
- 15) Shqipëria: mesatarja e ponderuar është aplikuar në kredi të reja 12-mujore gjatë muajit përkatës, mbi maturitet 12 mujor. Bosnja e Hercegovina: norma kredie afatshkurtër në valutën kombëtare për korporatat jofinanciare (mesatarja e ponderuar). Mali i Zi, 2014: norma efektive e interesit të mesatares së ponderuar, shumat e papaguara, vjetore. ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: fundi i vitit (31 dhjetor). Kosova, 2013: përfshin ngarkesat bankare për disbursim.
- 16) Shqipëria: norma e interesit për depozita paraqet mesataren e ponderuar për depozitat e sapo-pranuara në muajin përkatës, mbi maturitet 12 mujor. Bosnja e Hercegovina: norma e kërkuar për depozita të ekonomive familjare në valutën kombëtare (mesatarja e ponderuar). Mali i Zi, 2014: norma e interesit efektive, mesatarja e ponderuar, shumat e papaguara, vjetore. ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: fundi i vitit (31 dhjetor). Kosova, 2013: përfshin ngarkesën bankare për disbursim.
- 17) ish Republika Jugosllave e Maqedonisë: fundi i vitit (31 dhjetor).
- 18) ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia (vetëm në 2014), Bosnja e Hercegovina, Kosova dhe BE-28: bazuar në manualin për bilancin e pagesave, edicioni i 6të.
- 19) Bosnja dhe Hercegovina dhe Turqia: indeksi bruto.
- 20) Mali i Zi, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Kosova: llogaritjet e Eurostat.